



RAPORTI I TRETË I MONITORIMIT

Procesi i Berlinit në Agjendën e
Reformave Evropiane të Kosovës:

ANGAZHIMET PËR TREGUN E PËRBASHKËT RAJONAL DHE AGJENDËN E GJELBËR

Mars 2025

supported by:



Auswärtiges Amt



CRTA:



institut
alternativa





E drejta e autorit © 2025. Instituti Demokratik i Kosovës (IDK).

Instituti Demokratik i Kosovës rezervon të gjitha të drejtat dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet ose transmetohet në asnjë formë, mekanike ose elektronike, përfshirë fotokopjimin ose ndonjë material tjetër të sistemit të ruajtjes dhe rikthimit, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jo-komerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate ose materiale të ndryshme të këtij botimi është i detyruar të sqarojë burimin nga i cili ka marrë ato citime ose materiale të përdorura.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë ose sugjerim, ju lutemi na kontaktoni përmes opsioneve të dhëna më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr.239.

10,000, Prishtinë, Kosovë.

Tel: +383 (0) 38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Ueb: www.kdi-kosova.org

Ky raport u realizua në kuadër të projektit “*Diplomacia parlamentare: Bashkëpunimi rajonal përmes dialogut të zgjeruar parlamentar*”, i zbatuar me organizatat partnere nga rajoni me mbështetjen e Ministrisë Federale Gjermane të Punëve të Jashtme.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Ministrisë Federale Gjermane të Punëve të Jashtme.



HYRJE

Me 28 gusht të vitit 2025, do të bëhen 11 vite nga samiti i Berlinit, aty ku u lansua për herë të parë i ashtuquajti Procesi i Berlinit. Kjo nismë diplomatike e Kancelarës gjermane të asaj kohe Angela Merkel, synonte zgjidhjen e çështjeve të pazgjidhura të brendshme dhe ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor, arritjen e pajtimit brenda dhe midis shoqërive në rajon, rritjen e bashkëpunimit ekonomik rajonal dhe vendosjen e themeleve për rritje të qëndrueshme.¹ Përveç shteteve të Ballkanit Perëndimor, pjesëmarrëse në procesin e Berlinit janë edhe institucionet e BE-së, organet financiare ndërkombëtare, si dhe organizatat e shoqërisë civile, të rinjtë dhe bizneset brenda rajonit.²

Që nga viti 2014, në kuadër të këtij procesi janë mbajtur samite të rregullta vjetore, duke mbledhur udhëheqës nga Ballkani Perëndimor, shtetet anëtare të BE-së dhe palët përkatëse të interesit për të planifikuar dhe sinkronizuar veprimet e përbashkëta. Samiti i fundit dhe jubilar është mbajtur në kryeqytetin e Gjermanisë, në Berlin, në tetor të vitit 2024. Këto samite në fokus kanë tema të ndryshme si ekonomia, infrastruktura, sundimi i ligjit, siguria dhe nxitja e bashkëpunimit mes të rinjve.³

Përfaqësimi i Kosovës në Procesin e Berlinit jo vetëm që i ka mundësuar një platformë për angazhim të barabartë me vendet rajonale dhe BE-në, por gjithashtu ka forcuar pozicionin e Kosovës si një pjesëmarrëse aktive në formimin e iniciativave të bashkëpunimit rajonal.

Përmes pjesëmarrjes aktive, Kosova ka kontribuar në forcimin e lidhjeve dhe bashkëpunimit në mes të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe ka luajtur një rol thelbësor në përparimin e objektivave të partneritetit Berlin-Bruksel.⁴ Bashkimi në iniciativa si Rrjeti Trans-Evropian i Transportit (TEN-T) dhe nënshkrimi i marrëveshjeve si Traktati i Bashkëpunimit në Transport (TKT) në Samitin e Triestes janë hapa konkrete që tregojnë angazhimin e Kosovës për përmirësimin e infrastrukturës dhe lidhshmërisë së saj në kuadrin më të gjerë evropian.

Përveç kësaj, mbajtja e parimeve të përcaktuara në marrëveshjet për Marrëdhëniet e Mira fqinjësore dhe Bashkëpunimin Rajonal nënvizon përkushtimin e saj për forcimin e stabilitetit, paqes dhe përparimit në rajon. Duke plotësuar këto obligime dhe duke marrë pjesë aktivisht në iniciativat rajonale, Kosova jo vetëm që ka forcuar pozicionin e vet, por gjithashtu ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në objektivat më të gjera të promovimit të bashkëpunimit, integritetit dhe zhvillimit në Ballkanin Perëndimor.⁵

Mirëpo, mosmarrëveshjet e vazhdueshme dypalëshe, veçanërisht ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, dhe Kosovës dhe Bosnje e Hercegovinës, që rrjedhin nga kundërshtimet e këtyre dy shteteve për statusin e pavarur të Kosovës, kanë vendosur barriera në Procesin e Berlinit. Këto mosmarrëveshje kanë penguar zbatimin e marrëveshjeve që rrjedhin nga ky procesi, duke penguar bashkëpunimin e mirëfilltë rajonal dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor.⁶

1 Shih më shumë në faqen zyrtare të Procesit të Berlinit në, <https://www.berlinprocess.de/en/what-is-the-berlin-process>

2 Po aty.

3 Stiftung Wissenschaft und Politik, Procesi i Berlinit në Ballkanin Perëndimor: Ide të mëdha, zbatim i vështirë në, <https://www.swp-berlin.org/10.18449/2022C70/>

4 Shih Raportin e BPRG, "Procesi i Berlinit për Ballkanin Perëndimor: Përfitimet dhe Sfidat për Kosovën, fq.13. në https://balkangroup.org/wp-content/uploads/2018/01/Procesi-i-Berlinit-p%C3%ABr-Ballkanin-Per%C3%ABndimor_P%C3%ABrfitimet-dhe-sfidat-p%C3%ABr-Kosov%C3%ABn_Shqip.pdf

5 Po aty.

6 Koha Net, "Kurti kërkon të zbatohet marrëveshja për lëvizje të lirë mes Kosovës e Bosnjës", 11 prill 2024, në <https://www.koha.net/arberi/416045/kurti-komisionit-evropian-rkon-te-zbatohet-marreveshja-per-levizje-te-lire-mes-kosoves-e-bosnjes>

Me gjithë këto sfida, Kosova ka vazhduar të zbatojë zotimet që rrjedhin nga Procesi i Berlinit. Në shkurt të vitit 2023, Kuvendi i Kosovës ratifikoi tri marrëveshje të nënshkruara në kuadër të Procesit të Berlinit me 2/3 e votave,⁷ duke shënuar vendin e dytë në rajon që ratifikoi me shpejtësi të tre marrëveshjet.⁸ Marrëveshjet e ratifikuara përfshijnë Marrëveshjen për lëvizjen e lirë me karta identiteti në Ballkanin Perëndimor, Marrëveshjen për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë brenda rajonit dhe njohjen e kualifikimeve profesionale posaçërisht për mjekët, stomatologët dhe arkitektët sipas kornizës së Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA).⁵ Në tetor të vitit 2023 në Samitin e Tiranës, marrëveshja për njohjen e kualifikimeve u zgjerua tutje me profesione të reja, atë të infermierëve, veterinerëve, farmacistëve dhe mamive. Këto marrëveshje janë miratuar nga Qeveria e Kosovës në prill të vitit 2024⁹, me 6 muaj vonesë, ndërsa nga Kuvendi në maj 2024.¹⁰ Ndërsa, në Samitin e Berlinit në tetor 2024, liderët e Ballkanit Perëndimor morën vendime për forcimin e bashkëpunimit ekonomik, lëvizjen e studentëve, përparimin në reformat për integrimin në BE dhe përmirësimin e lidhjeve rajonale dhe infrastrukturës.

Përveç marrëveshjeve kryesore, Kosova është angazhuar për ekzekutimin e Planeve të Veprimit që rrjedhin nga Procesi i Berlinit, në fusha të ndryshme dhe zotimet e liderëve të rajonit të bëra gjatë samiteve të Berlinit. Këto zotime janë baza e nismave për tema si Tregu i Përbashkët Rajonal dhe Agjenda e Gjellbër. Kosova është një nga nënshkrueset e “Deklaratës së Sofjes” që definon obligimet për Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor dhe Deklaratën

për Zhvillimin e Tregut të Përbashkët Rajonal të vitit 2020.

Për të evidentuar shkallën e përmbyshjes së zotimeve nga ana e Kosovës sa u përket dy prej shtyllave të procesit të Berlinit, Tregun e Përbashkët Rajonal, me fokus Digjitalizimin dhe Agjendën e Gjellbër me fokus Dekarbonizimin, KDI ka publikuar raportin e parë të monitorimit në dhjetor 2023,¹¹ dhe raportin e dytë, në dhjetor 2024.¹²

Ndërsa, më poshtë do të shpalosen të gjeturat e raportit të tretë të monitorimit me informacione të përditësuara për fushat e lartpërmendura, për periudhën gusht 2024-shkurt 2025. Përveç, kësaj në këtë raport janë të përfshira edhe të dhënat lidhur me aspektet e këtyre dy komponentëve të procesit të Berlinit, të cilat janë përfshirë në Agjendën e Reformave Evropiane.

METODOLOGJIA

Raporti i tretë i monitorimit ka për qëllim vlerësimin e progresit të arritur nga ana e Kosovës në realizimin e angazhimeve të marra në kuadër të Procesit të Berlinit. Ky dokument do të përqendrohet kryesisht në realizimin e Planeve të Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal, me një fokus të veçantë në fushën e Digjitalizimit dhe Agjendën e Gjellbër me fokus në fushën e Dekarbonizimit, duke analizuar të gjitha aktivitetet që janë ndërmarrë nga institucionet e Kosovës gjatë periudhës së përmendur. Po ashtu do të vlerësohet, përfshirja e këtyre fushave në Agjendën e Reformave Evropiane në Planin e Rritjes për Ballkanin Perëndimor. Krahassimi

7 Portali Ekonomia Online, 23 shkurt, 2023 në, <https://ekonomiaonline.com/ratifikohen-tri-marreveshje-te-procesit-te-berlinit/>

8 Telegrafi, Shkurt, 2023, <https://shorturl.at/7oh3R>

9 Zyra e Kryeministrit, Vendimet e Qeverisë nga mbledhja 200, në <https://kryeministri.rks-gov.net/vendimet-e-mbledhjes-se-qeverise/>

10 Evidenca e Ligjeve të Kuvendit të Kosovës në, https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Evidencaeligjeve_YEeRbw38rY.pdf

11 Shih Raportin e parë të monitorimit në, <https://shorturl.at/SeLz1>

12 Shih Raportin e dytë të monitorimit në, <https://rb.gy/cytrr8>



do të shqyrtojë aspekte të ndryshme, duke përfshirë objektivat, statusin e implementimit dhe ndikimet e pritura në nivel rajonal.

Periudha që mbulohet nga ky raport shtrihet nga gushti i vitit 2024 deri në shkurt të vitit 2025. Audienca e synuar përfshin deputetët dhe stafin parlamentar të Kuvendit të Kosovës, veçanërisht ata që janë pjesë e komisioneve përkatëse që lidhen me çështjet e Procesit të Berlinit, si dhe akterë të tjerë nga ekzekutivi dhe publiku i gjerë.

Objektivi kryesor i këtij raporti është të ofrojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse mbi përmbushjen e angazhimeve të Kosovës në kuadër të Procesit të Berlinit për periudhën në fjalë. Informacionet që do të ofrohen janë të rëndësishme për deputetët dhe stafin parlamentar për të monitoruar përmbushjen e këtyre angazhimeve dhe për të siguruar nga Qeveria e Kosovës llogaridhënie për realizimin e angazhimeve të Procesit të Berlinit.

Për më tepër, ky raport do të adresojë obligimet e Kosovës dhe do të sugjerojë rekomandime për hapa të mëtejshëm për zbatimin e suksesshëm të Planeve të Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal/ Digjitalizimin dhe Agjendën e Gjellbër/ Dekarbonizimin. Ai gjithashtu do të identifikojë pengesat dhe sfidat që mund të ndikojnë negativisht në progresin dhe zbatimin e aktiviteteve të planifikuara.

Metodologjia e përdorur për mbledhjen e të dhënave përfshin analiza të burimeve ekzistuese dhe nga komunikimi me institucione kyçe. Po ashtu janë përdorur dokumente zyrtare, raporte nga institucionet e Ballkanit Perëndimor, Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, si dhe burime të tjera me referenca nga deklaratat e liderëve rajonalë në media. Për analizën e të dhënave, janë aplikuar metoda analitike

për të dhëna parësore dhe krahasuese, duke ofruar kështu një pasqyrë të plotë të progresit të arritur.

Rezultatet e analizës janë paraqitur në tabela të organizuara sipas Planeve të Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal dhe Agjendën e Gjellbër, të cilat janë të përfshira në Shtojcat e këtij Raporti.

1. ROLI I KUVENDIT NË PËRMBUSHJEN E ZOTIMEVE TË PROCESIT TË BERLINIT

Të dhënat e ofruara në Raportin e parë dhe të dytë të monitorimit kanë ofruar një bazë solide për deputetët dhe stafin parlamentar të Kuvendit të Kosovës për të ndjekur dhe vlerësuar progresin e zbatimit të angazhimeve të marra në kuadër të Procesit të Berlinit. Këto raporte kanë mundur një pamje të qartë të përpjekjeve të Qeverisë për të realizuar qëllimet e përcaktuara, duke e forcuar mbikëqyrjen dhe transparencën e veprimeve të institucioneve të Kosovës. Në këtë kuadër, Kuvendi ka luajtur rol legjislativ dhe mbikëqyrës, duke e njohur Procesin e Berlinit si një proces të rëndësishëm dhe të nevojshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës dhe rajonit. Si pasojë, ky proces është trajtuar jo vetëm si një angazhim i brendshëm, por edhe si një pjesë e angazhimit të Kosovës në krijimin e një Ballkani Perëndimor më të stabilizuar dhe të integruar.

Raporti i tretë i monitorimit, në këtë kontekst, synon të thellojë më tej angazhimin e Kosovës, të Qeverisë dhe Kuvendit, duke ofruar informacione të përditësuara dhe më të detajuara për ekzekutivin, deputetët dhe stafin parlamentar. Fuqizimi i Kuvendit të Kosovës për të mbajtur përgjegjëse Qeverinë në këtë proces është thelbësor,

pasi jo vetëm që forcon procesin e qeverisjes dhe transparencës brenda vendit, por gjithashtu thekson angazhimin e Kosovës në realizimin e qëllimeve rajonale dhe evropiane, duke kontribuar në stabilitetin politik dhe ekonomik të Ballkanit Perëndimor.

Kuvendi, si institucioni më i lartë ligjvënës në vend, ka përgjegjësinë e rëndësishme për hartimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e legjislacionit që ndërlidhet me Procesin e Berlinit dhe, më gjerë, me integrimin e Kosovës në strukturat evropiane.

Një aspekt i rëndësishëm i aktiviteteve të Kuvendit gjatë sesionit vjeshtor të vitit 2024 ka qenë miratimi i disa ligjeve kyçe që kanë të bëjnë me angazhimet e Kosovës në kuadër të Procesit të Berlinit. Vlen të theksohet se nga gjysma e muajit dhjetor aktiviteti i Kuvendit u pezullua për shkak të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e rregullta parlamentare. Në periudhën sa ishte në funksion, Kuvendi miratoi Projektligjin për rrugët, Projektligjin për financimin e menaxhimit të resurseve ujore, dhe Projektligjin për Inspektoratin qendror të mjedisit, ujërave, natyrës, ndërtimit si dhe për mbrojtjen nga rrezatimi dhe sigurinë bërthamore. Këto projektligje janë të rëndësishme për sigurimin e kornizës ligjore që mundëson realizimin e angazhimeve të Kosovës, sidomos në fushat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të mbrojtjes mjedisore, që janë të centralizuara në Procesin e Berlinit. Veç tyre në tetor 2024, Kuvendi miratoi edhe Programin Kombëtar për Integrim Evropian 2024 – 2028, pjesë e të cilit janë edhe disa komponentë të Procesit të Berlinit.¹³

Megjithatë, disa projektligje që lidhen ngushtë me Procesin e Berlinit, si ai për vlerësimin strategjik mjedisor dhe projektligji për menaxhimin e resurseve ujore, mbeten në procedurë, dhe kjo paraqet një sfidë për

progresin e përgjithshëm të implementimit të angazhimeve. Po ashtu, dy marrëveshje ndërkombëtare që lidhen me financimin e politikave zhvillimore për efektivitetin fiskal, konkurrueshmërinë dhe rritjen e gjelbër, si dhe marrëveshja për projektin e energjisë diellore fotovoltaike në KEK, nuk u miratuan gjatë legjislaturës që lamë pas. Të dyja këto marrëveshje janë të rëndësishme për realizimin e agjendës së Gjelbër dhe përmbushjen e objektivave të dekarbonizimit, të cilat janë një element kyç i Procesit të Berlinit dhe i planit për zhvillim të qëndrueshëm të Ballkanit Perëndimor.

Tashmë disa komponentë të Procesit të Berlinit janë pjesë integrale edhe e Agjendës së Reformave Evropiane dhe Rritjes për Ballkanin Perëndimor, që është një dokument kyç i miratuar në tetor të vitit 2024, për udhëheqjen dhe implementimin e reformave strukturore të nevojshme për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Ky zhvillim është një sinjal pozitiv që angazhimet e Kosovës në kuadër të Procesit të Berlinit janë tani më të integruara në një kornizë të gjerë reformash që shtrihen përtej përmbushjes së angazhimeve të procesit të Berlinit dhe kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve të brendshme dhe përgatitjen për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Në përfundim, është e qartë se, ndërsa ka pasur përparim në miratimin e legjislacionit të rëndësishëm, ende mbeten sfida dhe pengesa që kërkojnë angazhim të shtuar dhe koordinim të mëtejshëm ndërmjet Kuvendit dhe Qeverisë për të siguruar një realizim të plotë dhe efektiv të angazhimeve të marra. Pasqyra e këtij procesi, e mbështetur nga raporti i tretë i monitorimit, është një mjet i rëndësishëm për të vlerësuar progresin dhe për të siguruar që Kosova të mbetet e angazhuar dhe e përgjegjshme ndaj angazhimeve të saj rajonale dhe evropiane.



2. ZBATIMI I ZOTIMEVE TË PROCESIT TË BERLINIT NË DIGJITALIZIM DHE DEKARBONIZIM DHE PËRFSHIRJA NË AGJENDËN E REFORMAVE EVROPIANE

Qeveria e Kosovës ka marrë përsipër zotime të reja në kuadër të procesit të Berlinit gjatë vitit 2023 dhe vitit 2024. Në nëntor të vitit 2023 në Samitin e Tiranës u nënshkrua një marrëveshje e re dhe gjashtë deklarata të përbashkëta mes vendeve të Ballkanit Perëndimor, të cilat synojnë të thellojnë Tregun e Përbashkët Rajonal. Marrëveshja e nënshkruar për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale u shtri edhe në katër profesione të reja: atë për infermierët, mamitë, farmacistët, si dhe kirurgët veterinar. Kjo marrëveshje u mundëson qytetarëve që në shtetin pritës të ushtrojnë të njëjtin profesion për të cilin janë kualifikuar në shtetin amë dhe ta realizojnë këtë në kushte jo më pak të favorshme se sa qytetarët e shtetit pritës. Kuvendi i Kosovës e ratifikoi këtë marrëveshje në maj 2024, me 6 muaj vonesë.

Në ndërkohë, në prill 2024, Qeveria e Kosovës miratoi Planin Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2024 – 2028. Në këtë Plan theksohet se, në kontekstin e bashkëpunimit rajonal dhe integritit në BE, Republika e Kosovës është e përkushtuar të zbatojë obligimet që dalin nga Planet e Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal dhe Agjendën e Gjelbër të Ballkanit Perëndimor, në kuadër të Procesit të Berlinit.¹⁴ Me 30 tetor 2024, ky dokument u miratua edhe nga ana e Kuvendit të Kosovës.

Më poshtë dhe në dy Shtojcat e këtij raporti janë të paraqitura në mënyrë të detajuar të dhënat se sa Kosova ka përmbushur obligimet që burojnë nga procesi i Berlinit për dy fushat: Tregun e Përbashkët Rajonal pjesën e Digjitalizimit dhe Agjendën e Gjelbër, pjesën e Dekarbonizimit dhe cilat komponentët nga këto dy fusha janë integruar edhe në Agjendën e Reformave

Evropiane dhe Rritjes për Ballkanin Perëndimor.

2.1 Të gjeturat kryesore dhe Rekomandimet lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal/Digjitalizimi

Edhe gjatë kësaj periudhe raportuese (gusht 2024-shkurt 2025) Kosova ka vazhduar të ketë përparim të moderuar në zbatimin e Planit të Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal të Procesit të Berlinit, konkretisht pjesën e Digjitalizimit.

Kosova ka bërë hapa të avancuar në **shtrirjen e internetit**, me 98.6% të familjeve që kanë qasje në internet, duke tejkaluar mesataren e BE-së. Në kuadër të Agjendës së Reformave Evropiane, synohet krijimi i një infrastrukture digjitale të qëndrueshme dhe siguria e **shpërndarjes së teknologjisë 5G** deri në vitin 2027, duke arritur 20% të shtëpive dhe siguruar përputhshmërinë me standardet e BE-së për sigurinë kibernetike. Kosova ka bërë përparim në zhvillimin e rrjetit 5G, si pjesë e Agjendës Digjitale 2030, por Komisioni Evropian ka theksuar vonesat në implementim. Agjenda e Reformave Evropiane e Kosovës përcakton se do të harmonizohen politikat për zhvillimin e infrastrukturës 5G në përputhje me standardet dhe kërkesat e BE-së.

Rekomandim: Kosova duhet të përshpejtojë zhvillimin e rrjetit 5G dhe të përmbushë afatet e vitit 2025, duke siguruar mbulimin e qyteteve dhe korridoreve kryesore, dhe të përmirësojë koordinimin rajonal për harmonizimin e spektrit dhe licencimit 5G në përputhje me Agjendën e Reformave Evropiane.

Përsa i përket **ndërlidhjes së rrjeteve akademike dhe kërkimore**, në vitin 2021,



Kosova themeloi Rrjetin Kosovar të Kërkimit dhe Edukimit (KREN), i cili lidh institucionet e arsimit të lartë me rrjetin pan-evropian GEANT, duke mundësuar qasje në resurse për kërkimin shkencor. Po ashtu, KREN ka zgjeruar kapacitetet duke lidhur mbi 100 shkolla me internet. Në Agjendën e Reformave Evropiane të Kosovës, është përcaktuar krijimi i një sistemi arsimor të digjitalizuar, por nuk është përfshirë KREN si një trup kontribuuese në këtë proces.

Rekomandim: Kosova duhet të investojë në zgjerimin e rrjetit KREN, duke lidhur më shumë institucione dhe shkolla në lidhje të internetit me shpejtësi të lartë, duke mbështetur kërkimin, edukimin dhe inovacionin. Po ashtu, është e rëndësishme të vazhdohet bashkëpunimi me rrjetin GEANT dhe të rritet pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare, ndërsa një bashkërendim i MASHT dhe KREN është i nevojshëm për digjitalizimin e arsimit.

Kosova ka zbatuar me sukses **Marrëveshjen Rajonale për Roaming (MRR)** me vendet e Ballkanit Perëndimor, e cila ka hyrë në fuqi më 1 korrik 2021, duke iu përmbajtur kushteve të marrëveshjes. Gjithashtu, në Samitin BE-Ballkani Perëndimor të dhjetorit 2022, 38 operatorë nënshkruan një Deklaratë për uljen e tarifave të roamingut mes dy rajoneve, që pritet të reduktojë çmimin për 1GB të dhënave nga 18 € në 2023 në 9 € në 2028. Marrëveshja do të sjellë përfitime për qytetarët dhe bizneset, por është e nevojshme të zbatohet një model RLAH+ për të eliminuar përfundimisht tarifat e Roaming mes BP dhe BE.

Rekomandim: Siç është përcaktuar edhe në Agjendën e Reformave Evropiane, Kosova duhet të vazhdojë implementimin e Marrëveshjes Rajonale të Roamingut me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe të përshpejtojë zbatimin e udhërrëfyesit për uljen e tarifave të roamingut midis BE-së dhe BP-së, duke siguruar përfitime më të

mëdha për qytetarët dhe bizneset në rajon, si dhe duke ua komunikuar qytetarëve përfitimet e tarifave të ulura.

Kosova ka bërë përparim **në zhvillimin e aftësive digjitale**, duke nënshkruar një Marrëveshje Asocimi me Komisionin European dhe duke miratuar Strategjinë e Arsimit 2022-2026, që fokusohet në aftësitë digjitale. Agjenda Digjitale 2030 dhe Strategjia e e-Qeverisjes 2023-2027 theksojnë rëndësinë e zhvillimit të aftësive digjitale dhe qeverisjes digjitale. Megjithatë, Agjenda e Reformave Evropiane e Kosovës ka identifikuar probleme si infrastruktura joadekuate, mungesa e edukimit digjital të mësimitdhënësit dhe studentët, pabarazitë në qasje dhe financimi i pamjaftueshëm, të cilat pengojnë integrimin e mjeteve digjitale dhe përparimin arsimor. Për të përmirësuar situatën, në këtë dokument kërkohet një vlerësim gjithëpërfshirës të nevojave për kompetencat digjitale në sistemin arsimor.

Rekomandim: Kosova duhet të sigurojë burime të mjaftueshme për implementimin e Strategjive të Aftësive Digjitale dhe të vazhdojë përpjekjet për të përmirësuar infrastrukturën digjitale, zhvilluar aftësitë digjitale të mësuesve dhe nxënësve, si dhe për të adresuar pabarazitë për grupet e pafavorizuara dhe pakicat, duke reduktuar hendekun e kompetencave digjitale në arsim.

Kosova është ende në faza të hershme të zhvillimit të qyteteve inteligjente, me projekte të nisura në Gjilan dhe Prishtinë, që përfshijnë menaxhimin e trafikut dhe cilësisë së ajrit. Kosova është ende në faza të hershme të zhvillimit të qyteteve inteligjente, por ka filluar të ndërmarë hapa të rëndësishëm me projekte të nisura në disa komuna kryesore, si Gjilani dhe Prishtina. Këto projekte përfshijnë elementë të ndryshëm të menaxhimit të infrastrukturës urbane, si menaxhimi i trafikut dhe monitorimi i cilësisë së ajrit, të cilat janë pjesë të strategjisë për të krijuar



qytete më të qëndrueshme dhe efikase.

Rekomandim: Kosova duhet të harmonizojë standardet e qyteteve inteligjente me ato të Bashkimit Evropian për të mundësuar shkëmbimin e të dhënave dhe shërbimeve në mënyrë të sigurt dhe efikase. Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e menaxhimit të burimeve dhe shërbimeve publike, duke mundësuar ndërveprim më të mirë mes qyteteve dhe përfshirjen e teknologjive të avancuara dhe praktikave më të mira nga BE-ja.

Kosova është bërë pjesë e angazhimeve rajonale në **zhvillimin e Inteligjencës Artificiale (AI)** përmes krijimit të një Grupi Punues për AI në Ballkanin Perëndimor. Megjithatë, legjislacioni i Kosovës dhe rajonit është ende i pamjaftueshëm dhe i vjetëruar për të përmbushur standardet e BE-së për menaxhimin e AI-së.

Rekomandim: Pavarësisht se kjo çështje nuk është përfshirë në Agjendën e Reformave Evropiane, Kosova duhet të hartojë legjislacion të përshtatshëm për Inteligjencën Artificiale, duke u bazuar në praktikën e BE-së, dhe të forcojë bashkëpunimin rajonal për promovimin e AI-së dhe adresimin e kërcënimeve të sigurisë kibernetike.

Kosova ka përmirësuar **statistikat dhe transmetimin e të dhënave** te Eurostat, duke realizuar censusin e popullsisë dhe banesave. Megjithatë, ende nevojiten përmirësime në qasje më të mirë në të dhënat administrative rritje të kapaciteteve për raportimin e statistikave financiare. Po ashtu, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) kërkon përmirësime në menaxhim dhe koordinim.

Rekomandim: Kosova duhet të përmirësojë sistemet statistikore duke u mbështetur në Indeksin e BE-së dhe ITU, dhe të forcojë bashkëpunimin rajonal për analizën dhe monitorimin e statistikave.

Sa i përket **qeverisjes elektronike**, Kosova ka miratuar Strategjinë për Qeverisje Elektronike 2023-2027 dhe ka zgjeruar gamën e shërbimeve në platformën E-Kosova, e cila aktualisht ofron mbi 150 shërbime të digjitalizuara. Megjithatë, numri i shërbimeve publike online mbetet ende i ulët, duke përfaqësuar vetëm 10% të totalit të shërbimeve publike.

Rekomandim: Kosova duhet të intensifikojë bashkëpunimin rajonal për shkëmbimin e praktikave të mira në fushën e transformimit digjital dhe të rrisë numrin e shërbimeve publike të digjitalizuara për të përmirësuar efikasitetin e qeverisjes elektronike.

Lidhur me **mbrojtjen e të dhënave personale**, Kosova ka avancuar në përputhje me legjislacionin e BE-së për mbrojtjen e këtyre të dhënave. Agjencia për Informim dhe Privatësi monitoron zbatimin e ligjit dhe ka forcuar kuadrin ligjor me rregullore dhe udhëzime për kontrollorët e të dhënave dhe realizon inspekte për të siguruar që zbatimi i ligjit të jetë efektiv. Edhe pse ka kufizime në buxhet dhe kapacitete njerëzore, Agjencia është aktive në trajtimin e ankesave për qasje në dokumente publike dhe çështjet që lidhen me mbrojtjen e të dhënave.

Rekomandim: Kosova duhet të forcojë më tej mbrojtjen e të dhënave personale dhe të intensifikojë bashkëpunimin rajonal për të siguruar përputhshmërinë me standardet e BE-së në mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale. Gjithashtu, është e nevojshme fuqizimi i Agjencisë për Informim dhe Privatësi me buxhet dhe burime njerëzore të mjaftueshme, për të mundësuar një mbikëqyrje dhe implementim më të efektshëm të ligjeve për mbrojtjen e të dhënave personale.

Kosova ka përmirësuar ligjet dhe strategjitë për **sigurinë kibernetike** me miratimin e Ligjit dhe Strategjisë Kombëtare të Sigurisë



Kibernetike 2023-2027, si dhe ka inauguruar Qendrën Shtetërore të Trajnimit. Megjithatë, sulmet kibernetike mbeten një sfidë dhe kërkohet më shumë bashkëpunim rajonal. Agjenda e Reformave Evropiane kërkon që ekipet e sigurisë kibernetike të jenë plotësisht funksionale dhe të përmbushin standardet e BE-së.

Rekomandim: Në kuadër të Agjendës së Reformave, konsiderohet i rëndësishëm krijimi i një Grupi Punues Qeveritar për përputhshmërinë me standardet e BE-së për sigurinë kibernetike, duke përfshirë aktorët kyç. Po ashtu, Kosova duhet të forcojë ekipet e sigurisë kibernetike (CERT) dhe t'i bëjë plotësisht funksionale. Për më tepër, duhet të miratojë ligje që përputhen me standardet e BE-së dhe të intensifikojë bashkëpunimin rajonal për të adresuar kërcënimet kibernetike.

Të dhënat e detajuara lidhur me nivelin e zbatimit të secilës nënfushë Planit të Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal/ Zona Rajonale Digjitale dhe përfshirjen në Agjendën e Reformave Evropiane, gjenden në tabelën 1.1 në Shtojcën 1 të këtij Raporti.

2.2 Të gjeturat kryesore dhe Rekomandimet lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për Agjendën e Gjelbër/Dekarbonizimi

Edhe gjatë kësaj periudhe raportuese (gusht 2024-shkurt 2025) Kosova ka vazhduar të ketë përparim të moderuar në zbatimin e Planit të Veprimit për Agjendën e Gjelbër, konkretisht pjesën e Dekarbonizimit.

Kosova ka vendosur **objektivat për energjinë dhe klimën** deri në vitin 2030, që përfshijnë rritjen e pjesës së energjisë së ripërtëritshme në 32% dhe reduktimin e emetimeve të gazrave serrë me 16.3%. Megjithatë, sfidat mbeten të mëdha, duke përfshirë kapacitete të kufizuara, qasje

të pamjaftueshme në burime financiare ndërkombëtare dhe barrierat politike. Pas miratimit të Ligjit për Promovimin e Përdorimit të Energjinë të Ripërtëritshme, Kosova ka filluar zhvillimin e legjislacionit të nevojshëm dhe ka miratuar disa udhëzime për mbështetje të energjisë së ripërtëritshme.

Rekomandim: Kosova duhet të forcojë kapacitetet e saj për të arritur objektivat e energjisë dhe klimës, të rrisë investimet në infrastrukturën e energjisë dhe të përmirësojë bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar për të adresuar sfidat dhe të përmbushë angazhimet e vitit 2030.

Kosova ende nuk ka përfunduar **Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën**, i cili ka filluar të hartohet që nga viti 2018, ndonëse miratimi ishte planifikuar për dhjetor 2024. Në Raportin për Vendin 2024, Komisioni Evropian ka kërkuar nga Kosova që të miratojë këtë Plan sa më shpejt, duke e përputhur me rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Agjenda e Reformave Evropiane përfshin përpjekje për të përmbushur objektivat e përcaktuara në draft Planin Kombëtar, duke u fokusuar në uljen e emisioneve të gazrave serrë dhe rritjen e përdorimit të energjisë së ripërtëritshme, si dhe përmirësimin e efikasitetit të energjisë.

Rekomandim: Kosova duhet të përshpejtojë procesin e përfundimit dhe miratimit të Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën dhe të sigurojë që ai të jetë në përputhje me standardet e BE-së për të realizuar objektivat e energjisë dhe klimës deri në vitin 2030.

Kosova ende nuk ka miratuar **Strategjinë e Përshtatjes Klimatike**, e cila pritej të fillonte në gjysmën e dytë të vitit 2024. Aktualisht, ekzistojnë dokumente si Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2019-2028 dhe Plani i Veprimit por të së cilit ka skaduar afati në vitin 2019 dhe kërkon përditësim. Agjenda e Reformave thekson rëndësinë e zbatimit



të ligjeve për mbrojtjen e mjedisit, përfshirë Vlerësimin Strategjik të Mjedisit dhe Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor dhe Social.

Rekomandim: Kosova duhet të përshpejtojë miratimin e Strategjisë së Përshtatjes Klimatike dhe të përditësojë dokumentet ekzistuese. Po ashtu, duhet të integrojë masat e adaptimit ndaj klimës në politikat dhe projektet e zhvillimit.

Kosova është ende në faza të hershme në adresimin e sfidave mjedisore dhe klimatike, duke bërë progres të kufizuar në menaxhimin e mbeturinave, ajrit dhe ujit. Zbatimi i **zgjidhjeve natyrore për zbutjen dhe adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike** është i pamjaftueshëm. Për të përmirësuar situatën nevojiten zgjidhje si riciklimi, mbjellja e pemëve dhe menaxhimi i ujërave për të reduktuar emetimet e karbonit dhe për të rritur elasticitetin ndaj ndikimeve klimatike. Edhe Raporti i Komisionit Evropian 2024 thekson problemet me shpyllëzimin dhe menaxhimin e ujërave. Agjenda e Reformave të Kosovës parashikon angazhimin në përpjekjet për zbutjen dhe adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe parandalimin dhe kontrollin e ndotjes. Investimet e planifikuara synojnë të sigurojnë zbatimin e ligjeve dhe procedurave të mbrojtjes së mjedisit, duke përfshirë vlerësimet mjedisore dhe sociale, dhe konsultimet publike.

Rekomandim: Kosova duhet të intensifikojë përpjekjet për implementimin e zgjidhjeve natyrore në menaxhimin e mjedisit, si riciklimi, mbjellja e pemëve dhe menaxhimi i ujërave, për të reduktuar emetimet e karbonit dhe për të përmirësuar qëndrueshmërinë ndaj ndikimeve klimatike. Po ashtu, duhet të përmirësohet zbatimi i ligjeve dhe procedurave për mbrojtjen e mjedisit, duke adresuar problemet me shpyllëzimin dhe menaxhimin e ujërave, në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian dhe Agjendën e Reformave të Kosovës.

Kosova ka parashikuar **dekarbonizimin** në Strategjinë e re të Energjisë të miratuar në mars 2023, por ende nuk ka hartuar një Strategji të Dekarbonizimit, e cila është identifikuar si mangësi në Raportin e Komisionit Evropian 2023. Rishikimi i legjislacionit përfshinë Projektligjin për Energjinë dhe Projektligjin për Energjinë Elektrike, të cilat kanë kaluar procesin e diskutimit dhe komentimit nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Përveç këtyre, janë në përgatitje edhe Projektligji për Rregullatorin e Energjisë dhe Projektligji për Eficiencën e Energjisë. Politika e dekarbonizimit është përfshirë edhe në Agjendën e Reformave Evropiane, ku parashikohet rishikimi dhe miratimi i akteve nënligjore për zbatimin e ligjit për ndryshimet klimatike.

Rekomandim: Kosova duhet të hartojë një Strategji të Dekarbonizimit të plotë dhe të përshpejtojë miratimin e ligjeve dhe akteve nënligjore për mbështetje të dekarbonizimit të sektorit të energjisë, për të siguruar zbatimin efektiv të politikave klimatike dhe përputhshmërinë me legjislacionin e BE-së.

Kosova ka bërë përparim në **eficiencën e energjisë**, veçanërisht në sektorët rezidencial dhe privat, me mbështetje nga Paketa e Mbështetjes për Energjinë e financuar nga BE. Ligji i ndryshuar për performancën energjetike të ndërtesave u miratua në maj 2024, por ende kërkohet miratimi i Ligjit të ri për eficiencën e energjisë. Strategjia e Energjisë synon të kufizojë konsumimin e energjisë deri në vitin 2031. Në kuadër të Agjendës së Reformave Evropiane, Kosova synon transpozimin dhe zbatimin e plotë të Direktivës për Performancën Energjetike të Ndërtesave, duke përfshirë implementimin e Strategjisë për Rinovimin e Ndërtesave dhe Planit për Ndërtesat me Energji Gati Zero. Ky proces është në faza të avancuara, por ende nuk janë miratuar disa dokumente të nevojshme. Pavarësisht përfitimeve të dukshme sociale nga përmirësimi i



efikasitetit energjetik, pengesat mbeten të shumta, përfshirë ndërtesat e vjetra, mungesën e kapaciteteve dhe sfidat ligjore, financiare dhe teknike.

Rekomandim: Kosova duhet të përshpejtojë miratimin e Strategjisë për Rinovimin e Ndërtesave dhe Planin për Ndërtesat me Energji Gati Zero. Po ashtu, duhet të adresojë barrierat ligjore dhe financiare, si dhe të krijojë mundësi financimi për projektet e energjisë, veçanërisht për ndërtimet e vjetra dhe për banesat me të ardhura të ulëta.

Kosova ka arritur afër përmbytjes së objektivit të vitit 2020 për **përdorimin e energjisë së ripërtëritshme** dhe ka vendosur objektiva të reja në dhjetor 2022. Sipas Raportit për Vendin 2024, Kosova ka bërë përparime duke miratuar Ligjin për promovimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe duke lidhur tregun e energjisë me Shqipërinë. Megjithatë, ajo mbetet e varur nga centralët e energjisë me qymyr dhe ka nevojë të përshpejtojë implementimin e burimeve të ripërtëritshme në përputhje me strategjinë e saj energjetike. Për të arritur objektivat strategjike, Kosova ka për qëllim të arrijë 35% të energjisë elektrike nga burime të ripërtëritshme deri në vitin 2031, dhe ka nevojë të përshpejtojë zbatimin e projekteve të energjisë së ripërtëritshme.

Rekomandim: Kosova duhet të përshpejtojë implementimin e projekteve të energjisë së ripërtëritshme dhe të përmirësojë proceset e tenderimit konkurrues për të arritur objektivat e saj strategjike.

Varfëria energjetike është një problem i madh në Kosovë, ku 40% e familjeve nuk mund të mbajnë ngrohtësinë e duhur, më shumë se në pjesën tjetër të rajonit. Ky problem prek veçanërisht familjet me të ardhura të ulëta dhe ato nga komunitetet Roma, Ashkali, dhe Egjiptian. Shumë familje shpenzojnë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave për energji dhe shpesh

nuk mund të paguajnë faturat ose të ngrohin shtëpitë gjatë dimrit. Në Agjendën për Reforma Evropiane, theksohet se janë ndërmarrë hapa për të përballuar varfërinë energjetike, përfshirë përmirësimin e efikasitetit të energjisë dhe përdorimin e burimeve të ripërtëritshme. Por, masat aktuale për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë janë të pamjaftueshme për të adresuar rritjen e kostove të energjisë dhe për të përmirësuar standardet e jetesës.

Rekomandim: Kosova duhet të vazhdojë mbështetjen e skemave financiare për përmirësimin e kushteve të jetesës për familjet në varfëri energjetike, duke zgjeruar mundësitë për financimin e pajisjeve efikase dhe vazhduar mbështetjen për konsumatorët e cenueshëm.

Kosova ka bërë përparime të kufizuara në zbatimin e Acquis-it të **transportit hekurudhor** dhe legjislacioni hekurudhor ende kërkon harmonizim të plotë me standardet e BE-së. Punimet për stacionin hekurudhor të përbashkët me Maqedoninë e Veriut kanë përfunduar, por nisja e operacioneve është vonuar. Po ashtu, punimet në Korridorin Orient/East-Med po zhvillohen me ritëm të ngadaltë. Qeveria i ka përfshirë dy projektligje për hekurudhat në Planin Legjislativ 2024, por ato nuk u dërguan për miratim në Kuvend.

Rekomandim: Kosova duhet të përshpejtojë harmonizimin e legjislacionit hekurudhor me standardet e BE-së dhe të miratojë projektligjet për hekurudhat sa më shpejt. Po ashtu, është e nevojshme të përshpejtohen punimet për stacionin e përbashkët hekurudhore rajonale.

Kosova ka miratuar Strategjinë e Transportit Multimodal 2023-2030, që synon të rrisë përdorimin e transportit hekurudhor dhe ujon si **alternativa të qëndrueshme për transportin e mallrave dhe udhëtarëve**, duke ndihmuar në reduktimin e ndotjes dhe ngarkesës në rrugë. Në vitin 2021, Kosova miratoi gjithashtu Strategjinë e



Lëvizshmërisë së Qëndrueshme dhe të Zgjuar për Ballkanin Perëndimor, që synon harmonizimin me politikat e transportit të BE-së. Agjenda e Reformave Evropiane parashikon digjitalizimin e sistemeve të transportit dhe implementimin e një Rrjeti Bërthamor ITS, që do të rrisë efikasitetin dhe sigurinë e infrastrukturës.

Rekomandim: Kosova duhet të përshpejtojë implementimin e Strategjisë së Transportit Multimodal dhe të investojë më shumë në alternativat e qëndrueshme, si transporti hekurudhor dhe ujqor. Po ashtu, është e nevojshme të përshpejtohet digjitalizimi dhe implementimi i Sistemit Inteligent të Transportit (ITS), në përputhje me standardet e BE-së.

Sa i përket, zhvendosjes së trafikut nga rruga në hapësira më miqësore me mjedisin, Kosova e ka përfshirë këtë çështje në Strategjinë e Transportit Multimodal 2023-2030, e cila parasheh rritjen e përdorimit të transportit hekurudhor dhe ujqor si alternativa më të qëndrueshme dhe të sigurt për transportin e mallrave dhe udhëtarëve. Kjo ka për qëllim të reduktojë ndotjen dhe ngarkesën në rrugë, duke kontribuar në mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit. Agjenda e Reformave parashikon digjitalizimin e sistemeve të transportit të qëndrueshëm, të sigurt dhe miqësor me mjedisin, si dhe zbatimin e Rrjetit Bërthamë/Gjithëpërfshirës ITS onTEN-T në Kosovë. Ky projekt është i përfshirë në Strategjinë e Transportit Multimodal 2023-2030 dhe në Planin e Veprimit të Strategjisë së Transportit Multimodal 2023-2025.

Rekomandim: Kosova duhet të përshpejtojë zbatimin e Strategjisë së Transportit Multimodal, me fokus të veçantë në rritjen e përdorimit të transportit hekurudhor dhe ujqor. Po ashtu, është e domosdoshme të përshpejtohet digjitalizimi i sistemeve të transportit në përputhje me standardet e BE-së dhe me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Sa i përket **transportit inteligjent**, Kosova ka bërë përparime në këtë fushë sa i përket dokumenteve strategjike. Gjatë vitit 2024 ka miratuar Strategjinë për sistemin e transportit inteligjent 2024-2030. Megjithatë, ende nevojiten hapa të mëtejshëm për të miratuar një Plan Veprimi dhe sigurimin e burimeve të mjaftueshme për zbatim. Veç kësaj, integrimi i transportit inteligjent është pjesë Strategjisë së Transportit Multimodal 2023-2030. Në kuadër të saj, është planifikuar implementimi i Sistemit Inteligent të Transportit (ITS) dhe e-transportit, në përputhje me Direktivën ITS të BE-së, si dhe ndërtimi i stacioneve digjitale për autobusët.

Rekomandim: Kosova duhet të miratojë sa më shpejt Planin e Veprimit për transportin inteligjent dhe të sigurojë burimet e nevojshme për implementimin e tij. Po ashtu, është e nevojshme të përshpejtohet implementimi i Sistemit Inteligent të Transportit (ITS) dhe ndërtimi i stacioneve digjitale për autobusët, në përputhje me Direktivën ITS të BE-së.

Sa i përket përparimeve në **përmirësimin e transportit**, ende ka sfida në përputhshmërinë me Acquis-in e BE-së, veçanërisht në sektorët e transportit rrugor, hekurudhor dhe ajror. Ligji për Rrugët është miratuar në tetor 2024, por legjislacioni hekurudhor kërkon përputhje të mëtejshme me Paketën e Katërt të Hekurudhës të BE-së. Në transportin ajror, Kosova ka kufizime për shkak të mosanëtarësimit në organizata ndërkombëtare të aviacionit civil. Në kuadër të Agjendës Evropiane, përmendet puna për ndërtimin e autostradës Prishtinë – Merdare dhe hekurudhës në Korridorin 10 e cila ka avancuar ngadalë. Po ashtu, Kosova ka vonesa në tenderimin e sistemeve të sinjalistikës dhe telekomunikacionit, të cilat janë të rëndësishme për implementimin e projekteve TEN-T.

Rekomandim: Kosova duhet të sigurojë përputhjen me legjislacionin hekurudhor të BE-së. Po ashtu, duhet të punojë



për anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare të aviacionit civil. Për avancimin e projekteve TEN-T, është e domosdoshme të përshpejtohet ndërtimi i autostradës Prishtinë – Merdare dhe hekurudhës në Korridorin 10, si dhe të eliminohen vonesat në tenderimin e sistemeve të sinjalistikës dhe telekomunikacionit.

Në prill 2024, Qeveria e Kosovës krijoi Këshillin e Sigurisë Rrugore për të monitoruar zbatimin e strategjive dhe për të përmirësuar sigurinë rrugore. Por, Kosova ende duhet të bëjë hapa tutje për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të arritur qëllimet ndërkombëtare për **uljen e aksidenteve** dhe vdekjeve deri në vitin 2030. Përshtatja me Direktivën për menaxhimin e sigurisë së infrastrukturës rrugore ende nuk është e plotë, dhe krijimi i një sistemi për të rritur kapacitetin e inspektorëve dhe auditorëve të sigurisë rrugore mbetet sfidë. Edhe në Agjendën e Reformave Evropiane, theksohet se Kosova duhet të intensifikojë veprimet për krijimin e një sistemi të menaxhimit të aseteve rrugore dhe përputhjen e sistemit të të dhënave të aksidenteve me protokollin CADaS. Kjo është e domosdoshme për të përmbushur angazhimet ndërkombëtare për uljen e aksidenteve dhe vdekjeve nga aksidentet rrugore deri në vitin 2030, siç është përcaktuar nga OKB dhe BE.

Rekomandim: Kosova duhet të punojë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe implementimin e masave për uljen e aksidenteve dhe vdekjeve deri në vitin 2030. Përshtatja me Direktivën për menaxhimin e sigurisë së infrastrukturës rrugore dhe krijimi i një sistemi për rritjen e kapacitetit të inspektorëve dhe auditorëve të sigurisë rrugore duhet të jenë prioritet. Po ashtu, duhet të intensifikohen përpjekjet për krijimin e një sistemi të menaxhimit të aseteve rrugore dhe përputhjen e të dhënave të aksidenteve me protokollin CADaS për të përmbushur angazhimet ndërkombëtare.

Asnjë shtet i Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën, nuk ka përgatitur ose miratuar një Strategji për **përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike për sektorin e transportit**. Deri më tani, Kosova ka krijuar një grup punues për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike, duke synuar përfshirjen e planeve të qëndrueshmërisë klimatike në rrjetin e transportit. Në Agjendën e Reformave, theksohet se reduktimi i ndikimit mjedisor të transportit, përmes uljes së emetimeve dhe konsumin të karburantit, është një sfidë e madhe.

Rekomandim: Kosova duhet të përshpejtojë hartimin dhe miratimin e një Strategjie të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike duke përfshirë edhe sektorin e transportit dhe të integrojë planet e qëndrueshmërisë klimatike në rrjetin e transportit. Po ashtu, është e domosdoshme të zbatohet Sistemi i Transportit Inteligjent për të reduktuar ndikimet mjedisore, duke ulur emetimet dhe konsumin e karburantit.

Asnjëra prej shteteve të Ballkanit Perëndimor nuk ka miratuar Direktivën e BE-së për **Infrastrukturën Alternative të Karburantit**. Kosova ka filluar përpjekjet për të përmirësuar qëndrueshmërinë e transportit, duke përfshirë investime si Marrëveshja e Kredive për autobusë elektrikë në Prishtinë. Në muajin maj 2024, KESCO, kompania energjetike publike, instaloi stacione mbushjeje për automjetet elektrike në të gjitha rrethet e Kosovës, si pjesë e iniciativës për promovimin e automjeteve elektrike dhe uljen e ndotjes së ajrit. Në Agjendën e Reformave, theksohet se duhet të reduktohet ndikimi mjedisor i transportit duke ulur emetimet dhe konsumin e karburantit.

Rekomandim: Kosova duhet të vazhdojë të implementojë infrastrukturën për karburante alternative dhe të transpozojë Direktivat e BE-së për përdorimin e energjisë së ripërtëritshme. Për më tepër, është e rëndësishme të zhvillohen më tej stacionet



PROCESI I BERLINIT NË AGJENDËN E REFORMAVE EVROPIANE TË KOSOVËS: **ANGAZHIMET PËR TREGUN E PËRBASHKËT RAJONAL DHE AGJENDËN E GJELBËR?**

e furnizimit për automjetet elektrike, duke mbështetur mjedisin e pastër dhe duke reduktuar ndikimin mjedisor të transportit. Kjo duhet të përfshijë investime të mëtejshme për të promovuar përdorimin e energjisë së ripërtëritshme në transportin publik dhe automjetet elektrike.

Të dhënat e detajuara lidhur me nivelin e zbatimit të secilës nënfushë Planit të Veprimit për Agjendën e Gjelbër/ Dekarbonizimi dhe përfshirjen në Agjendën e Reformave Evropiane, gjenden në tabelën 1.2 në Shtojcën 2 të këtij Raporti.



SHTOJCA

1. Të dhëna të detajuara për zbatimin e Planit të Përbashkët të Veprimit të Tregut Rajonal/ Digjitalizimi dhe përfshirja në Agjendën e Reformave Evropiane

**TABELA 1.1: TREGU I PËRBASHKËT RAJONAL – ZONA RAJONALE DIGJITALE
– AGJENDA E REFORMAVE EVROPIANE– PLANI I VEPRIMIT**

Aktiviteti	Afati kohor	Ecuria (politikat, aktivitetet)	Aktiviteti në Planin e Veprimit të Agjendës së Reformës Evropiane	Afati kohor në Agjendën e Reformave Evropiane
7.1. Infrastruktura digjitale dhe lidhja	2024	Duke cituar Raportin e Konkurrueshmërisë në Ballkanin Perëndimor 2024 të OECD-së, Komisioni Evropian, në Raportin për Vendin ka evidentuar se Kosova është e para në rajonin e Ballkanit Perëndimor për sa i përket qasjes në internet, me 98.6% të familjeve që kanë një formë të qasjes në internet. Kjo shifër kalon mesataren e BE-së, e cila është 93.08%. Megjithatë, Kosova përballlet me sfida në përdorimin e internetit me linjë të fiksuar, i cili mbetet nën mesataren rajonale. Faktorët kryesorë që kontribuojnë në këtë janë infrastruktura me cilësi më të ulët, mungesa e rrjeteve në disa zona, çështjet e përballeshmërisë dhe kërkesa e ulët për këtë lloj shërbimi.¹⁵ Rritjes së shtrirjes së internetit në vend i ka ndihmuar, Programi i Ekonomisë Digjitale të Kosovës (KODE) i zbatuar nga Ministria e Ekonomisë, e mbështetur nga Banka Botërore. Përmes këtij programi janë mbështetur me grante kompanitë e sektorit privat për të investuar në shtrirjen e internetit në zonat rurale. Të 203 fshatrat, duke përfshirë 105 shkolla dhe 43 qendra të kujdesit shëndetësor, janë lidhur me internet me lidhje të kabllave fibra optik. Gjatë 2021- deri në tre mujin e parë të vitit 2024, më shumë se 6 kulla celulare janë lidhur me teknologjinë e fibrave optik për të qenë gati për rrjetet 5G. Numri i përdoruesve celular përmes rrjeteve mobile 4G dhe 5G është në rritje të vazhdueshme, dhe deri më tani depërtimi i qasjes në internet - celular në Kosovë është rreth 100%.¹⁶	Në Agjendën e Reformave Evropiane të Kosovës, në kuadër të nënfushës, Digjitalizimi i shërbimeve dhe infrastrukturave publike, është paraparë, krijimi i një infrastrukture digjitale të sigurt, elastike dhe të qëndrueshme, duke përfshirë infrastrukturën rurale dhe mobile të internetit dhe shpërndarjen e teknologjisë 5G, në pajtueshmëri me Paketën e Mjeteve të BE-së për sigurinë kibernetike 5G të masave lehtësuese për adresimin e rreziqeve të sigurisë. Lidhur me këtë, Kosova ka vendosur si synim përafrimin me Aktin e Infrastruktursë Gigabit, shpërndarjen e rrjetit dhe shërbimeve 5G për të arritur në 20% të shtëpive dhe Pajtueshmërinë me kutinë e mjeteve të sigurisë kibernetike të BE-së 5G.¹⁷	Dhjetor 2027

15 Raporti për Vendin i Komisionit Evropian 2024, fq. 52, 53 në, https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf

16 Intervistë e KDI-së me përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe përgjigje me shkrim në periudhën maj-qershor 2024.

17 Instrumenti për reforma dhe rritje ekonomike për Ballkanin Perëndimor, Agjenda e Reformave e Kosovës (tutje: Agjenda e Reformave Evropiane të Kosovës 2024), fq. 127 në, https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/11f55bfd-f916-4456-87d7-5d74d884ab54_en?filename=SWD_2024_243_3_EN_autre_document_travail_service_part1_v3.pdf

2. Krijimi i Zyrave të Kompetencës së Internetit të Gjerë (BCO) në Ballkanin Perëndimor (ku ato nuk ekzistojnë) dhe forcimi i kapaciteteve të tyre për të mbështetur qasjen e gjerë në internet	2021	Zyra Kosovare për Kompetencat me brez të gjerë (BCO) është themeluar në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe menaxhon projektin për zgjerimin e infrastrukturës fikse të qasjes së gjerë në internet. BCO e Kosovës ka bashkëpunime dhe merr pjesë në takimet e organizuara nga rrjeti i BCO-ve të BE-së. ¹⁸	Ndonëse kjo komponentë nuk është integruar në Agjendën e Reformave Evropiane të Kosovës, Qeveria e Kosovës duhet të zbatojë kërkesën e Planit të Veprimit duke rritur kapacitetet e Zyrës së Kompetencës së Internetit të Gjerë (BCO) dhe duke intensifikuar bashkëpunimin me BCO-të e Bashkimit Evropian për shkëmbim njohurish dhe integrim në rrjetin e BE-së.	n/a
3. Ndërlidhja e rrjeteve akademike dhe kërkimore në Ballkanin Perëndimor (BP6), me mbështetjen dhe bashkëpunimin e rrjetit GEANT	2022	Kosova ka bërë përparim në përmirësimin e lidhjes së rrjetit akademik dhe kërkimor. Projekti KODE themeloi Rrjetin Kosovar të Kërkimit dhe Edukimit (KREN) në vitin 2021, dhe në fund të atij viti, Qendra e tij e të Dhënave u bë funksionale, duke ofruar Microsoft Azure dhe shërbime të tjera për institucionet e arsimit të lartë (IAL). Në vitin 2022, KREN lidhi me sukses të gjitha IAL-të me rrjetin pan-evropian GEANT. Përpjekjet vazhduan në 2023 dhe në fillim të 2024 për të lidhur 100 shkolla fillore dhe të mesme me KREN, me plane për të arritur 220 shkolla deri në fund të 2024. KREN ka krijuar gjithashtu bashkëpunim të fortë me GEANT dhe rrjetet kombëtare rajonale të kërkimit dhe arsimit (NREN). ¹⁹ Në korrik 2024, përfaqësuesit e GEANT vizituan Kosovën ku takuan Ministrinë e Ekonomisë. CEO i GÉANT e përgëzoi zhvillimin e shpejtë të KREN-it që nga krijimi i tij në nëntor 2022, duke theksuar avancimet e rëndësishme të shërbimeve të tij në një periudhë të shkurtër. Po ashtu, u vlerësua lidhja e 100 shkollave lokale me rrjetin me shpejtësi të lartë të KREN-it dhe rëndësia e popullsisë së re dhe të aftë teknologjike të Kosovës për zhvillimin e zgjidhjeve inovative. ²⁰	Në Agjendën e Reformave Evropiane të Kosovës, në kuadër të fushës së Arsimit, bazuar në Strategjinë e Arsimit 2022 – 2026, është përcaktuar që të prezantohet një sistem arsimor i digjitalizuar duke zbatuar infrastrukturën digjitale në shkolla, duke ofruar materiale mësimore digjitale dhe duke zhvilluar shkathtësitë digjitale të mësimit dhënësve. Mirëpo në këtë dokument përveç MASHT nuk është vendosur KREN/ME si një nga trupat që do të mund të kontribuonte në këtë proces. Një bashkërendim i MASHT dhe ME/KREN është i nevojshëm.	Dhjetor 2027

18 Intervistë e KDI-së me përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe përgjigje me shkrim në periudhën maj-qershor 2024.

19 Intervistë e KDI-së me përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe përgjigje me shkrim në periudhën maj-qershor 2024.

20 Shih në, <https://connect.geant.org/2024/07/31/geants-ceo-visit-in-south-east-europe-strengthening-re-collaboration-in-the-region-and-supporting-colleagues-in-bosnia-herzegovina-part-2>

4. Zhvillimi i hartës rrugore 5G për Ballkanin Perëndimor (BP6) dhe sigurimi i zbatimit efektiv në përputhje me afatin kohor të përcaktuar	2023	Ndonëse, strategjia e Agjendës Digjitale e Kosovës 2030, e miratuar në qershor 2023, përfshin planet për zhvillimin e rrjetit 5G,²¹ në Raportin për Vendin, Komisioni Evropian ka theksuar se në Kosovë ka vonesa në zhvillimin e rrjetit 5G.²² Plani i lëshimit të frekuencave, i miratuar nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), përfshin brezat kyç të frekuencave për 5G dhe ka ndarë brezat 800 MHz dhe 3.5 GHz për operatorët ekzistues. Që nga fillimi i vitit 2023, mbulimi 5G është i disponueshëm në qendrat e qyteteve dhe deri në vitin 2024/25, rrjeti 5G pritet të mbulojë korridoret kryesore si Morinë-Prishtinë dhe Prishtinë-Hani i Elezit.	Në Agjendën e Reformave Evropiane të Kosovës, është përcaktuar që Kosova do të harmonizojë legjislacionin e saj me Aktin e Infrastrukturaes Gigabit të BE-së dhe do të vendosë masa për të siguruar shpërndarjen e infrastrukturës 5G, në përputhje me kutinë e sigurisë kibernetike 5G të BE-së. Në këtë drejtim, synohet, shpërndarja e rrjetit dhe shërbimeve 5G për të arritur në 20% të shtëpive.²³ Për t'u përafruar më tej me planin e veprimit, Kosova duhet të përmirësojë koordinimin rajonal duke bashkëpunuar më ngushtë me ekonomitë e Ballkanit Perëndimor për të harmonizuar spektrin 5G dhe licencimin. Është thelbësore të sigurohet që të gjitha qytetet kryesore industriale të kenë mbulim 5G dhe të vazhdohet me mbulimin e planifikuar 5G për korridoret kryesore Morinë-Prishtinë dhe Prishtinë-Hani i Elezit deri në fund vitin 2024/25.	Qershor 2027
5. Ulja e tarifave të Roaming-ut brenda BP6 dhe BE-BP përmes zbatimit të Marrëveshjes së Roamingut të BP-së dhe Udhërrëfyesit për uljen e tarifave të Roamingut midis BE-së dhe BP-së		Kosova ka zbatuar me sukses Marrëveshjen Rajonale për Roaming (MRR) me vendet e Ballkanit Perëndimor, e cila ka hyrë në fuqi që nga 1 korriku 2021, duke iu përmbajtur kushteve dhe kriterëve të marrëveshjes.²⁴ MRR konsiderohet si një nga arritjet më të rëndësishme të Agjendës Digjitale për Ballkanin Perëndimor, si dhe Planit Shumëvjeçar të Veprimit për Zonën Ekonomike Rajonale në Ballkanin Perëndimor dhe Tregut të Përbashkët Rajonal.²⁵ Edhe Raporti i BE-së për Kosovën i vitit 2023 ka rikonfirmuar se, Kosova është angazhuar në mënyrë konstruktive në dialogun rajonal të nivelit të lartë për transformimin digjital dhe zbatimin e Marrëveshjes Rajonale të Roamingut.²⁶	Në Agjendën e Reformave Evropiane të Kosovës, theksohet si arritje kyçe angazhimi konstruktiv i Kosovës në dialogun rajonal për transformimin digjital dhe roli i saj në zbatimin e Marrëveshjes Rajonale për Roaming nga korriku 2021.²⁷	

21 Shih Agjendën Digjitale të Kosovës 2030 në, <https://arKomisionitEvropianp-rks.org/desk/inc/media/82582FB3-CD31-4D3D-A2AA-F7CC21ACADCA.pdf>

22 Raporti i Komisionit Evropian për Vendin 2024, fq.70.

23 Agjenda e Reformave Evropiane të Kosovës 2024, fq.127.

24 Intervistë e KDI-së me përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe përgjigje me shkrim në periudhën maj-qershor 2024.

25 Shih më shumë për Roamingun në, https://www.rcc.int/priority_areas/53/roaming

26 Raporti i BE-së për Kosovën 2023, fq. 69.

27 Agjenda e Reformave Evropiane të Kosovës 2024, fq. 12.

Veprimet Rajonale

5.1. Përfundimi i fazës përfundimtare të Marrëveshjes Rajonale të Roaming	2021	Plani i Veprimit ka përcaktuar zero tarifa Roaming të shitjes me pakicë brenda BB6 që nga 1 korriku 2021; Qëllimi përfundimtar i MRR-së për të futur regjimin e Roam Like at Home (RLAH) (Roaming si në shtëpi-RSSH) në rajon që nga 1 korriku 2021 u arrit me sukses dhe u krijua rajoni i BB-së pa roaming, që do të thotë se aktualisht, konsumatorët e BP-së nuk paguajnë tarifa shtesë për thirrjet, SMS-të dhe të dhënat celulare gjatë roamingut në rajon, krahasuar me atë që paguajnë në shtëpi.²⁸ Futja e regjimit të RLAH nga 1 korriku 2021 rezultoi në rritje të konsiderueshme të konsumit/përdoruesit të të gjitha shërbimeve roaming në rajon, duke konfirmuar kështu ndjeshmërinë e lartë të çmimeve të roamerëve të BP.²⁹	n/a
5.2. Përfundimi i Planit të detajuar për uljen e tarifave të Roamingut midis BE-së dhe BP-së dhe zbatimi efektiv në përputhje me afatin kohor të përcaktuar	2021	Plani i Veprimit përcakton, uljen e tarifave të Roamingut midis BP dhe BE në përputhje me pikat e rëna dakord në Planin e detajuar; Në Samitin BE-Ballkani Perëndimor më 6 dhjetor 2022, 38 operatorë telekomunikacioni nga BE-ja dhe Ballkani Perëndimor nënshkruan një Deklaratë Roaming për të ulur tarifat e Roaming ndërmjet rajoneve duke filluar nga 1 tetori 2023. Marrëveshja do të ulë çmimin maksimal të shitjes me pakicë për 1 gigabajt e të dhënave nga 18 € në 2023 në 14 € në 2026 dhe 9 € në 2028, me rishikime vjetore të planifikuara. Megjithatë, marrëveshjet aktuale vullnetare nuk adresojnë plotësisht nevojat e përdoruesve. Prandaj, reduktime të mëtejshme në çmimet e roaming dhe futja e një modeli RLAH+ janë të nevojshme për të eliminuar përfundimisht plotësisht tarifat e roaming.³⁰ Në Raportin për Vendin për Kosovën të vitit 2024, Komisioni Evropian ka evidentuar se Plani i veprimit për Roaming midis Ballkanit Perëndimor dhe BE-së ka hyrë në fazën e parë të zbatimit.³¹	Ndonëse, nuk është përcaktuar në Agjendën për Reforma Evropiane, Kosova duhet të punojë në zbatimin e udhërrëfyesit për reduktimin e tarifave të roamingut BE-BB dhe të vazhdojë bashkëpunimin me partnerët rajonalë dhe të BE-në në këtë drejtim. Për më tepër, duhet të komunikojë përfitimet e tarifave të reduktuara të roaming për publikun dhe bizneset për të maksimizuar ndikimin e marrëveshjes.

28 Shih më shumë në, https://www.rcc.int/priority_areas/53/roaming

29 Po aty, fq.30.

30 Intervistë e KDI-së me përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe përgjigje me shkrim në periudhën maj-qershor 2024.

31 Raporti për Vendin 2024, fq. 58.

7.2. Aftësitë dhe kompetencat digjitale

1. Zhvillimi i strategjive të aftësive digjitale dhe dakordimi për veprime rajonale afat-shkurtra dhe afatmesme për përmirësimin e aftësive digjitale	2022-2023	Në qershor 2024, Kosova ka nënshkruar një Marrëveshje Asocimi me Komisionin Evropian për t'u bashkuar me Programin Digjital Evropian të financuar nga BE, i cili ka për qëllim të rrisë qasjen në digjitalizim për individët, bizneset dhe institucionet.³² Po ashtu, është miratuar Strategjia e Arsimit 2022-2026 në nëntor 2022, një nga fushat kryesore të së cilës është Edukimi Digjital, i cili përqendrohet në përmirësimin e aftësive digjitale për qytetarët.³³ Në Agjendën Digjitale 2030, "Popullsia me aftësi digjitale" është një nga objektivat e Strategjisë.³⁴ Po ashtu edhe, Strategjia e e-Qeverisjes 2023-2027 e miratuar së fundi paraqet reforma thelbësore në qeverisjen digjitale në Kosovë. Strategjia thekson nevojën për një qasje më kohezive, duke u fokusuar në koordinimin e qeverisjes elektronike, sigurinë kibernetike, tërheqjen dhe mbajtjen e talenteve dhe zhvillimin e aftësive digjitale. Megjithatë, Raporti i KE-së për Vendin i vitit 2023 ka theksuar se, për zbatimin e suksesshëm, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHTI) duhet të sigurojë burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare.³⁵	Në Agjendën e Reformave Evropiane të Kosovës, transformimi digjital është një nga shtyllat e këtij dokumenti, ndërsa si dokument Strategjik i referohet Strategjisë së Arsimit 2022-2026 dhe Agjendën Digjitale 2023.	Dhjetor 2026 – 2027
---	-----------	--	---	---------------------

32 Po aty, fq.70.

33 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Tregut të Përbashkët Rajonal i vitit 2022, fq.34.

34 Po aty.

35 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2023, fq.105.

2. Krijimi i një depoje kursesh dhe programesh të tjera trajnimi të zhvilluara nga organizata të ndryshme, duke përfshirë MOOC-të me universitete të themeluara, bazuar në analizën e boshllëqeve të Ballkanit Perëndimor dhe nevojat për aftësi digjitale për grupet e synuara	2022-2023	Qëllimi i Planit të Veprimit në këtë drejtim është rritja e aftësive digjitale për grupet e ndryshme. Çdo vit duhet të trajnohen të paktën 50 persona. Për të adresuar hendekun e aftësive digjitale, Kosova ka trajnuar mbi 1,500 përfitues përmes projektit IPA të BE-së dhe 900 të rinj të tjerë përmes Projektit KODE të Bankës Botërore, me plane për të arritur në 2,000 deri në fund të vitit 2024. Për më tepër, Ministria e Ekonomisë po mbështet zhvillimin e sektorit të TI-së duke krijuar një Park Teknik në Prishtinë për rritjen e sektorit privat dhe duke krijuar një Qendër Digjitale të Ekselencës në Prizren për të avancuar njohuritë në trendet e reja të TIK-ut si 5G, IoT, AI, të dhëna të mëdha dhe printimi 3D.³⁶	Në Agjendën e Reformave Evropiane të Kosovës, theksohet se, digjitalizimi në arsim përballlet me probleme si infrastruktura joadekuate, mungesa e edukimit digjital në mesin e mësimitdhënësve dhe studentëve, pabarazitë në qasje dhe financimi i pamjaftueshëm. Këto sfida pengojnë integrimin efektiv të mjeteve digjitale, duke rezultuar në mundësi të pabarabarta të të mësuarit dhe duke penguar përparimin e përgjithshëm arsimor.³⁷ Por, përmes implementimit të infrastrukturës digjitale në shkolla dhe duke synuar arritjen e një niveli të lartë të njohurive të kompetencës digjitale për mësuesit, si dhe zhvillimin e materialeve digjitale mësimore, sistemi arsimor i Kosovës pritet të kalojë në një tranzicion digjital.³⁸ Për më tepër, rritja e ndërgjegjësimit të publikut për mundësitë e zhvillimit të aftësive digjitale do të ndihmojë në nxitjen e punësimit dhe rritjen ekonomike. Si synim është vendosur që, bazuar në Strategjinë e Arsimit 2022 – 2026, të prezantohet një sistem arsimor i digjitalizuar duke zbatuar infrastrukturën digjitale në shkolla, duke ofruar materiale mësimore digjitale dhe duke zhvilluar shkathtësitë digjitale të mësimitdhënësve. Po ashtu, zhvillimi i infrastrukturës dhe kapitalit njerëzor në fushën e TIK-ut dhe Ekonomisë Digjitale.³⁹ Niveli i kompetencave digjitale të sistemit arsimor ende nuk është vlerësuar. Prandaj, në Program theksohet që së pari kërkohet një vlerësim gjithëpërfshirës për të identifikuar nevojat e sakta. Sipas MASHTI-it nevojiten investime në kompetencat digjitale të nxënësve, edukatorëve dhe mësimitdhënësve të të gjitha niveleve, si dhe të gjithë personelit të institucioneve arsimore të të gjitha llojeve dhe niveleve të arsimit.⁴⁰ Deri në fund të vitit 2026, të paktën 40% e mësimitdhënësve duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë një nivel bazë të njohurive të kompetencave digjitale për mësimitdhënësit.⁴¹	Dhjetor 2026-2027
--	------------------	--	--	--------------------------

36 Intervistë e KDI-së me përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe përgjigje me shkrim në periudhën maj-qershor 2024.
37 Agjenda e Reformave Evropiane të Kosovës 2024, fq.14.
38 Po aty, fq. 20.
39 Agjenda e Reformave Evropiane të Kosovës 2024, fq. 25.
40 Po aty, fq. 70,71.
41 Po aty.

3. Zhvillimi i Planeve të Veprimit për Arsimin Digjital dhe promovimi i barazisë në qasje, veçanërisht për grupet e pafavorizuara dhe pakicat, veçanërisht romët	Qeveria e Kosovës në vitin 2022 ka miratuar Strategjinë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë e Kosovës 2022-2026 dhe Planin e Veprimit 2022-2024.⁴² Megjithatë në këtë Strategji nuk parashihet arsimimi digjital për grupet e pafavorizuara dhe pakicat. Ndërsa as Agjenda Digjitale 2030 nuk parasheh ndonjë masë të veçantë për këto grupe. Ngjashëm ndonjë masë nuk parashihet as me Planin e Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2021-2023.⁴³	Në Agjendën e Reformave Evropiane të Kosovës, theksohet që digjitalizimi në arsim përballët me probleme si infrastruktura joadekuatë, mungesa e edukimit digjital në mesin e mësimeve dhe studentëve, pabarazitë në qasje dhe financimi i pamjaftueshëm. Këto sfida pengojnë integrimin efektiv të mjeteve digjitale, duke rezultuar në mundësi të pabarabarta të të mësuarit dhe duke penguar përparimin e përgjithshëm arsimor. Megjithatë në këtë dokument, nuk është bërë ndonjë specifikim për grupet e pafavorizuara dhe pakicat.	Dhjetor 2026-2027
Ekonomia digjitale në epokën e teknologjive të reja të TIK-ut			
1. Organizimi i takimeve të rregullta të nivelit të lartë, duke përfshirë Samitin Vjetor Digjital, për të siguruar që agjenda digjitale të jetë në ballë të transformimit rajonal	Vjetore	Deri më tani ka pasur gjashtë Samite digjitale të mbajtura në vendet e Ballkanit Perëndimor. Samiti i fundit digjital është mbajtur gjatë vitit 2023 në Sarajevë. Ndërsa, Samiti i katërt digjital 2021 i mbajtur në Podgoricë dhe ai i vitit 2022 i mbajtur në Prishtinë, theksojnë prioritetet për përmirësimin e mjedisit digjital në Ballkanin Perëndimor për vitin vijues.^{44dhe45} Për më tepër, takimet e rregullta ministrore të TIK-ut shërbejnë gjithashtu si një platformë e nivelit të lartë për të adresuar veprimet thelbësore rajonale drejt një rajoni më të mirë të lidhur digjitalisht.⁴⁶	Në Agjendën e Reformave Evropiane të Kosovës theksohet, mikpritja e Samitit Digjital të Ballkanit Perëndimor në Prishtinë, në shtator 2022, i cili nënvizoi më tej përkushtimin e Kosovës për digjitalizim.⁴⁷

42 Shih Strategjinë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë e Kosovës 2022-2026 dhe Planin e Veprimit 2022-2024 në, <https://shorturl.at/bx1bn>

43 Shih Planin e Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2021-2023 në, <https://shorturl.at/RUilF>

44 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Tregut të Përbashkët Rajonal i vitit 2021, fq. 15.

45 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Tregut të Përbashkët Rajonal i vitit 2022, fq. 21.

46 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Tregut të Përbashkët Rajonal i vitit 2021, fq. 15.

47 Agjenda e Reformave Evropiane të Kosovës 2024, fq. 12.

2. Përafrimi i standardeve për metadata për të dhënat e hapura në nivel rajonal bazuar në standardet e BE-së për t'u zbatuar në të gjithë rajonin dhe për të nxitur parimin e të dhënave të hapura	2023	Kjo kategori e Planit të Veprimit për TBR, parashikon, aplikimin e standardeve të BE-së për të dhënat e hapura në nivel rajonal; Gjithashtu, që të mundësohet përdorimi i të dhënave për nevojat dhe hulumtimet qeveritare dhe më të gjera të sektorit publik. Me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së administratës shtetërore, Qeveria e Kosovës është duke zbatuar Iniciativën për të Dhëna të Hapura, të menaxhuar nga Ministria e Administratës Publike.⁴⁸ Megjithatë sipas Raportit për Vendin të viti 2024, Kosova ende duhet të harmonizojë legjislacionin e saj me acquis-në e BE-së për të dhënat e hapura dhe ri-përdorimin e informacionit të sektorit publik.⁴⁹	Ndonëse nuk është e vendosur si kategori në Agjendën e Reformave Evropiane, Kosova duhet të punojë në përafrimin e standardeve të saj për të dhëna të hapura, bazuar në standardet e BE-së. Përveç kësaj, Kosova duhet të promovojë përdorimin e të dhënave të hapura për të përmbushur nevojat e sektorit të gjerë publik dhe hulumtimit, duke siguruar që të dhënat të jenë të qasshme dhe të përdorshme për këto qëllime.
3. Arritja e një marrëveshjeje për ndërveprimin rajonal të shërbimeve të pagesave në Ballkanin Perëndimor	2022-2024	Plani i Veprimit i TBR parashikon rënien dakord për një sistem të unifikuar pagese në vendet e Ballkanit Perëndimor për të mundësuar udhëtime të pandërprera ndërkufitare. Rruga drejt arritjes së ndërveprimit përfshin aranzhime ligjore, teknike dhe operacionale, duke përfshirë pajtueshmërinë me direktivat e BE-së, protokollet e harmonizuara për shkëmbimin e të dhënave dhe vlerësimet e investimeve për përmirësimet e sistemit. Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të marrin në konsideratë zbatimin e një qasjeje me faza për të unifikuar sistemet e tyre elektronike të pagesave. Shfrytëzimi i infrastrukturës ekzistuese dhe përafrimi gradual me standardet e BE-së do të hapë rrugën për ndërveprim të pandërprerë, duke siguruar operacione me kosto efektive dhe duke lehtësuar integrimin rajonal.⁵⁰ Top of Form	Ndonëse nuk përmendet në Agjendën e Reformave Evropiane, në Raportin për Vendin 2024, Komisioni Evropian ka kërkuar nga Kosova që të harmonizojë legjislacionin me Kornizën e Ndërveprueshmërisë Evropiane dhe Aktin e Ndërveprueshmërisë Evropiane. Sipas kësaj, autoritetet e Kosovës duhet të sigurojnë dhe lehtësojnë qasjen e barabartë në shërbimet online për të gjithë dhe të intensifikojnë veprimet për të harmonizuar kuadrin ligjor me Aktin për Shërbimet Digjitale (DSA) dhe Aktin për Tregjet Digjitale (DMA).

48 Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës, Open Data në, <https://mpb.rks-gov.net/ap/page.aspx?id=2,33>

49 Raporti për Vendin i Komisionit Evropian 2024, fq. 70.

50 Raporti i Komunitetit të Transportit, Tolling interoperability in Western Balkans Executive, në <https://www.transport-community.org/wp-content/uploads/2023/04/TC-WB-Interoperability-ExecSummary-202211.pdf>

4. Marrëveshje mbi parimet dhe standardet e përdorura për qytetet inteligjente, bazuar në standardet e BE-së, me synimin për të siguruar ndërveprim të dhënave dhe shërbimeve	2023	Qëllimi i Planit të Veprimit është të ketë një shkëmbim të përmirësuar të standardeve të aplikuara për shërbimet kryesore, praktikat më të mira, etj. Gjithashtu që të krijohet një rrjet i qyteteve inteligjente në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Në Maj të vitit 2024, Ministria e Ekonomisë dhe komuna e Gjilanit kanë nënshkruar Marrëveshjen e mirëkuptimit, për realizimin e Projektit “Pilotimi i konceptit të Smart City (Neutral Host)”, në Komunën e Gjilanit, në vlerë financiare 550,000,00 euro. Projekti i “Qytetit të Mençur” i mundëson komunës që të menaxhojë më mirë resurset dhe të ofrojë shërbime më të mira, duke u bazuar në të dhënat të cilat vijnë nga sensorët e ndryshëm dhe në përfundimet që vijnë nga interpretimi i tyre.⁵¹ Në janar 2025, Nënkrjetari i Komunës së Prishtinës paraqiti projektin “Prishtina Smart City”, i cili ka për qëllim krijimin e një infrastrukture digjitale të avancuar për qytetin. Ky projekt do të përfshijë sisteme për monitorimin e qarkullimit të automjeteve, menaxhimin e trafikut, matjen e cilësisë së ajrit, si dhe implementimin e teknologjive të reja dhe sistemeve menaxhuese që do të kontribuojnë në përmirësimin e shërbimeve publike dhe jetës qytetare, duke bërë Prishtinën më moderne dhe të qëndrueshme.⁵²	Transporti inteligjent dhe i qëndrueshëm është listuar edhe në Agjendën e Reformave Evropiane. Në këtë drejtim, Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Ekonomisë duhet të zgjerojë praktikën e Marrëveshjes me Komunën e Gjilanit për Qytetet e Mençura edhe me komunar tjera.	2026
5. Ndërmarrja e veprimeve rajonale për të promovuar Inteligjencën Artificiale (AI) në aspekte të zgjedhura dhe bazuar në praktikat e BE-së	2024	Lidhur me Inteligjencën Artificiale (AI), Ballkani Perëndimor u angazhua të krijojë një Grup Punues rajonal të nivelit të lartë, i cili do të punojë në të gjitha aspektet e AI-së për të siguruar sinergji me BE-në. Kjo u ra dakord në Samitin e 5-të digjital të Ballkanit Perëndimor që u zhvillua në Prishtinë, Kosovë, më 21 dhe 22 shtator 2022.⁵³ Për t’u përballur më mirë me kërcënimet e sigurisë kibernetike, BP vendosi të përmirësojë bashkëpunimin brenda rajonit, por edhe me BE-në, në veçanti Komisionin Evropian dhe Agjencinë e Bashkimit Evropian për Sigurinë Kibernetike. Qëllimi është rritja e mbrojtjes së infrastrukturës kritike, parandalimi dhe zbulimi i kërcënimeve kibernetike, si dhe zbulimi dhe reagimi efektiv ndaj incidenteve.⁵⁴ Një studim i Fondacionit SHARE ka zbuluar se vendet e Ballkanit Perëndimor – aktualisht kanë rregulla të pamjaftueshme për të përmbushur kërkesat e epokës digjitale. Legjislacioni ekzistues është shpesh i vjetëruar, i fragmentuar dhe nuk i përmbush standardet evropiane, veçanërisht në menaxhimin e inteligjencës artificiale.⁵⁵ Në Maj të vitit 2024, BE ka miratuar një Ligj për Inteligjencën Artificiale. Kjo mund të shërbejë si shembull për Kosovën dhe vendet e rajonit për të draftuar legjislacionin për AI.	Ndonëse një zhvillim aktual, promovimi dhe rregullimi i Inteligjencës Artificiale (AI) nuk është përfshirë në Agjendën e Reformave Evropiane të Kosovës.	

51 Ministria e Ekonomisë dhe Komuna e Gjilanit nënshkruajnë Marrëveshjen për realizimin e Projektit “Qyteti i Mençur”, Maj 2024, në <https://me.rks-gov.net/blog/ministria-e-ekonomise-dhe-komuna-e-gjilanit-nenshkruajne-marreveshjen-per-realizimin-e-projektit-qyteti-i-mencur/>

52 “Nënkrjetari i komunës së Prishtinës prezanton projektin “Prishtina Smart City”, janar 2025, në, <https://ata.gov.al/2025/01/09/nenkryetari-i-komunes-se-prishtines-prezanton-projektin-prishtina-smart-city/>

53 Faqja zyrtare e BE-së, Ballkani Perëndimor punon së bashku në përmirësimin e transformimit digjital në <https://rb.gy/fbonjt>

54 Po aty.

55 Shih këtë studim në, <https://www.sharefoundation.info/en/digital-ecosystem-of-the-western-balkans-from-regulatory-gap-to-systemic-approach/>

Fushat Prioritare: Veprimet rajonale

6. Ndërmarrja e aktiviteteve rajonale për të lehtësuar pjesëmarrjen e Ballkanit Perëndimor në programet e Bashkimit Evropian për Informatikë me Performancë të Lartë (HPC)	2023-2024	Plani i Veprimit i TPR përcakton që deri në vitin 2024, të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor duhet të integrohen me rrjetin informatikë me performancë të lartë të BE-së. Për më tepër, duhet të rritet përdorimi i Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF) për të mbështetur projektet dhe investimet e HPC-së në rajon. Ndërmarrja e Përbashkët Evropiane për Performancë të Lartë Kompjuterike (Euro PLK) synon të përmirësojë cilësinë e jetës së qytetarëve evropianë, të avancojë shkencën, të rrisë konkurrencën industriale dhe të sigurojë autonominë teknologjike të Evropës. Është subjekt juridik dhe financimi, i krijuar në vitin 2018 dhe me vendndodhje në Luksemburg. Ai bashkon burimet e Bashkimit Evropian, 32 vendeve evropiane dhe tre partnerëve privatë. Nga Ballkani Perëndimor bëjnë pjesë vetëm Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.⁵⁶ Deri më sot, Kosova nuk i ka shfrytëzuar shërbimet e ofruara nga Euro HPC. Megjithatë, ka një vlerësim të vazhdueshëm brenda Kosovës në lidhje me miratimin e mundshëm të këtyre shërbimeve në përpjekjet e saj të ardhshme.⁵⁷ Kriteret për të hyrë në burimet e EuroHPC janë të ngjashme me ato për të hyrë në shërbimet e përgjithshme të HPC. Ato shpesh përfshijnë kërkesat e përshtatshmërisë, një proces aplikimi që përshkruan nevojat kompjuterike, pajtueshmërinë me politikën e përdorimit, demonstrimin e ekspertizës, tarifat e mundshme dhe menaxhimin e disponueshmërisë së burimeve gjatë kërkesës së lartë. Megjithatë, detajet specifike mund të ndryshojnë në bazë të iniciativës Euro HPC dhe strukturave të saj partnere.	n/a
--	-----------	---	-----

⁵⁶ Faqja zyrtare e BE-së, Ndërmarrja e Përbashkët Evropiane e Informatikës me Performancë të Lartë në, <https://rb.gy/fbonjt>
⁵⁷ Intervistë e KDI-së me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë nëntor 2023.

7. Ndërmarrja e aktiviteteve rajonale për të përmirësuar disponueshmërinë, analizën dhe monitorimin e statistikave të ekonomisë digjitale me cilësi të lartë, duke u mbështetur në Indeksin e Ekonomisë dhe Shfaqjes Digjitale të BE-së (DESI) dhe Indeksin e Zhvillimit të TIK-ut të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU)	2022	Sipas Raportit për Vendin 2024, Kosova ka bërë përparime në fushën e statistikave, përfshirë shpërndarjen e produkteve të reja statistikore dhe përmirësimin e transmetimit të të dhënave të Eurostat. Censusi i popullsisë dhe i banesave u realizua dhe rezultatet paraprake u publikuan në korrik 2024. Për vitin 2025, Komisioni Evropian ka rekomanduar që Kosova të sigurojë qasje më të mirë në të dhënat administrative, sidomos nga Autoritetet Tatimore dhe Doganat, dhe të vazhdojë të rrisë numrin e produkteve statistikore dhe shpërndarjen e tyre.⁵⁸ Po ashtu, Kosova duhet të rrisë kapacitetin e saj për të raportuar mbi statistikën financiare të qeverisë sipas ESA 2010 dhe të sigurojë monitorimin e rregullt të standardeve.⁵⁹ Po ashtu, zbatimi i kuadrit ligjor për infrastrukturën statistikore në Kosovë ka nevojë të forcohet. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) duhet të përmirësojë rolin e saj si autoritet kryesor për statistikën zyrtare, të rrisë koordinimin ndërmjet institucioneve kombëtare dhe të sigurojë më shumë qasje në të dhënat administrative. Infrastruktura dhe sistemet e brendshme të ASK-së kërkojnë përmirësime të vazhdueshme, dhe proceset e menaxhimit mbeten sfiduese. Transmetimi i të dhënave në Eurostat është duke u përmirësuar, dhe ASK-ja ka nisur një faqe të re interneti në korrik 2023, e cila duhet të zhvillohet më tej me më shumë përmbajtje.⁶⁰	n/a	
8. Bashkëpunimi rajonal në lidhje me shkëmbimin e praktikave të mira në fushën e transformimit digjital, në veçanti E-qeverisjes	Vjetore	Gjatë vitit 2023 është miratuar edhe Strategjia e Kosovës për Qeverisje Elektronike 2023- 2027.⁶¹ Raporti për Vendin i vitit 2024, e thekson këtë arritje, megjithatë, sipas tij numri i shërbimeve mbetet i ulët, duke përfaqësuar vetëm 10% të shërbimeve publike të disponueshme online.⁶² Portali i E-qeverisjes E-Kosova është funksional. Platforma ofron mbi 150 shërbime plotësisht të digjitalizuara.⁶³ Kosova ka zgjeruar dukshëm gamën e saj të shërbimeve në platformën e-qeverisë dhe ka iniciuar plane për të modernizuar dhe digjitalizuar lejet dhe licencat brenda të njëjtës platforme.⁶⁴	Në Agjendën e Reformave të Kosovës, përmendet E-qeverisja ku theksohet se numri i shërbimeve të ofruara online është ende i ulët.⁶⁵ Në këtë dokument synohet që, me hapat e paraparë dhe me përpjekjet shtesë të paktën 50% e 700 shërbimeve publike sipas katalogut të shërbimeve, të ofrohen online përmes portalit e-Kosova deri në fund të vitit 2027.⁶⁶	Dhjetor 2027

58 Raporti për Vendin i Komisionit Evropian 2024, fq.10.

59 Po aty, fq.15.

60 Po aty, fq.55.

61 Shih Strategjinë për Qeverisje Elektronike këtu, <https://rb.gy/7h760z>

62 Raporti për Vendin i Komisionit Evropian, fq.70.

63 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2023, fq.96.

64 Po aty fq.103.

65 Shih Agjendën e Reformave për Kosovën fq.43 në, https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/11f55bfd-f916-4456-87d7-5d74d884ab54_en?filename=SWD_2024_243_3_EN_autre_document_travail_service_part1_v3.pdf

66 Po aty, fq. 44.

7.4. Besimi dhe siguria

1. Marrëveshje për standardet dhe specifikimet minimale teknike për të lejuar shkëmbimin e të dhënave dhe dokumenteve dhe kryerjen e aktiviteteve pilot	2021 Pilotimi 2022- 2023	Sipas Raportit për Vëndin 2024, sasia e informacionit të shkëmbyer nga ana e Kosovës përmes Aplikacionit të Rrjetit të Shkëmbimit të Informacionit të Sigurt (SIENA) u rrit ndjeshëm.⁶⁷ Megjithatë, sipas KE, përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme në forcimin e koordinimit dhe shkëmbimit të të dhënave në kohë mes institucioneve kyçe në vend.⁶⁸ Dogana e Kosovës shkëmben në mënyrë sistematike të dhëna për lëvizjen kufitare të mallrave mes ekonomive të Ballkanit Perëndimor.⁶⁹ Në nivel rajonal, CEFTA Traces NT u lansua në korrik 2022 dhe u pilotua për të mundësuar shkëmbimin e të dhënave dhe dokumenteve në lidhje me certifikatat fitosanitare dhe dokumentet e zakonshme në shëndetësi. Versioni i ri i Paketës së Transparencës mbahet në cloud të CEFTA-s dhe sjell përmirësim të ndjeshëm në krahasim me gjendjen e mëparshme. Sistemi përdor teknologjinë më të fundit, është më i sigurt dhe më i fuqishëm dhe më i lehtë për mirëmbajtje. Të gjitha bazat e të dhënave janë përmirësuar në mënyrë funksionale dhe teknike dhe manualët shoqëruesë të përdoruesve janë shpërndarë dhe përdoruesit janë trajnuar.⁷⁰	Në Agjendën e Reformave Evropiane evidentohet që aktualisht ekziston një kontakt i Policisë së Kosovës që shërben si pikë kontakti për OLAF-in për të lehtësuar shkëmbimin e informatave dhe për të koordinuar përpjekjet e përbashkëta dhe bashkëpunimin e përgjithshëm.⁷¹ Po ashtu është vendosur si një nga planet, Marrëveshjet e koordinimit me Komisionin Evropian, veç kanaleve egzistuese të drejtpërdrejta me Zyrën e BE-së në Kosovë. Kjo shihet si e nevojshme për shkëmbimin e shpejtë dhe efektiv të informacionit, koordinimin e aktiviteteve dhe përafrimin e mesazheve. Më tej, bazuar në udhëzimet e komunikimit dhe dukshmërisë së BE-së, një tjetër synim është të sigurohet transparencë dhe përshtatshmëri e plotë në komunikim.⁷²
2. Përafrimi i veprimeve rajonale për të siguruar mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë në Ballkanin Perëndimor, bazuar në standardet e BE-së	2023	Ligjet e Kosovës për mbrojtjen e të dhënave personale përputhen ngushtë me legjislacionin e BE-së. Agjencia për Informim dhe Privatësi monitoron zbatimin e ligjit. Është forcuar kuadri ligjor me rregullore dhe udhëzime për kontrollorët dhe inspektimet. Pavarësisht kufizimeve në buxhet dhe fuqi punëtore, Agjencia trajton ankesat për qasje në dokumente publike dhe çështjet e mbrojtjes së të dhënave në mënyrë të pavarur dhe efektive.⁷³ Në nivel rajonal një ngjarje e nivelit të lartë për mbrojtjen e të dhënave në Ballkanin Perëndimor dhe Rajonin e Partneritetit Lindor, u organizua në shtator 2023 nga SIGMA dhe organizata të tjera rajonale. Përfaqësues nga 11 vende duke përfshirë edhe 6 vende të BP diskutuan sfidat dhe mundësitë, duke theksuar nevojën për bashkëpunim ndërkombëtar, dhe rëndësinë e përshtatjes së Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave me teknologjitë në zhvillim.⁷⁴	Agjenda e Reformave Evropiane nuk e ka përfshirë çështjen e mbrojtjes së të dhënave personale.

67 Raporti për Vëndin 2024, fq.8.

68 Po aty, fq.58.

69 Po aty, fq.77.

70 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Tregut të Përbashkët Rajonal 2022, fq.16.

71 Agjenda e Reformave Evropiane, fq.115.

72 Agjenda e Reformave të Kosovës, fq. 122.

73 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2023, fq.31.

74 Shih më shumë në, <https://rb.gy/c2zq8e>

3. Zhvillimi i programeve të mentorimit për Ekipet e Reagimit ndaj Incidentit të Sigurisë Kompjuterike të Ballkanit Perëndimor (CSIRT) dhe institucione të tjera si bashkëpunim afatgjatë me CSIRT-të e avancuara dhe partnerë të tjerë	2023	Sipas Raportit për Vendin 2024, për sa i përket besueshmërisë digjitale dhe sigurisë kibernetike, Kosova ka forcuar kuadrin e saj ligjor dhe strategjik për sigurinë kibernetike. Ligji për sigurinë kibernetike është pjesërisht i përshtatur me Direktivën NIS.⁷⁵ Por, Komisioni Evropian, ka kërkuar nga Kosova që të përshtatë legjislacionin e saj me Kodin Evropian të Komunikimeve Elektronike, Direktivën e Sigurisë së Rrjetit dhe Informacionit të BE-së (NIS2), Kutinë e Mjeteve të BE-së për sigurinë e 5G, Aktin për Shërbimet Digjitale dhe Aktin për Tregjet Digjitale.⁷⁶ Ligji i Sigurisë Kibernetike, është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në shkurt 2023. Gjithashtu, Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike 2023-2027 u miratua në shtator 2023. Ndërsa në mars 2024, u inaugurua Qendra Shtetërore e Trajnimit për Sigurinë Kibernetike, e cila synon rritjen e sigurisë kibernetike përmes trajnimeve të specializuara dhe mbështetjes së sektorit publik ashtu edhe për atë privat.⁷⁷ Një hulumtim i BIRN-it i realizuar në qershor 2023 nxjerr në pah një rritje të konsiderueshme të sulmeve kibernetike, veçanërisht, në të gjithë Ballkanin nga viti 2020 deri në vitin 2023. Kjo rritje lidhet me përdorimin më të madh të internetit dhe mbështetjen në teknologjitë biometrike dhe të identitetit digjital. Vendet si Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Kosova si dhe Serbia janë përballur me kërcënime të shtuara kibernetike. Kosova është përgjigjur duke forcuar kornizën e saj të sigurisë kibernetike. Gjetjet theksojnë nevojën urgjente për rritjen e ndërgjegjësimit publik, përmirësimin e politikave të sigurisë kibernetike dhe bashkëpunimin më të madh rajonal për të adresuar këto kërcënime në zhvillim dhe për të mbrojtur infrastrukturën kritike digjitale.⁷⁸ Më 16 tetor 2023, gjatë samitit të Procesit të Berlinit në Tiranë, u nënshkrua një traktat për krijimin e Qendrës së Kapaciteteve Kibernetike të Ballkanit Perëndimor (WB3C) si një organizatë ndërkombëtare. Ky veprim synon të rrisë qëndrueshmërinë kibernetike në rajon duke ofruar trajnime dhe nxitur bashkëpunimin për sigurinë kibernetike dhe krimin kibernetik. WB3C, që pritet të jetë funksional deri në vitin 2025, do të bashkojë partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë për të përmirësuar kapacitetet kibernetike dhe për të forcuar lidhjet midis Ballkanit Perëndimor dhe BE-së.⁷⁹	Agjenda e Reformave Evropiane i kushton një vëmendje mjaft të madhe çështjes së sigurisë kibernetike. Aty parashikohet krijimi i një kornize të përmirësuar për qëndrueshmërinë kibernetike, duke forcuar kapacitetet e institucioneve përkatëse. Në këtë kuadër, Agjenda e Reformave do të sigurojë që CERT-et qeveritare të jenë plotësisht funksionale dhe që Kosova të ketë futur kornizat e CVD dhe menaxhimit të krizave, siç është parashikuar në aktet përkatëse të BE-së.⁸⁰ Sa i përket sigurisë kibernetike, në kuadër të Agjendës së Reformave, Kosova ka listuar kornizë gjithëpërfshirëse për elasticitetin kibernetik (prezantimi i kërkesave të Direktivës NIS2 dhe forcimi i institucioneve përkatëse). Në këtë drejtim synohet që CERT kombëtar dhe ai qeveritar të jenë funksionale dhe të arrijnë të paktën statusin e 'akredituar' në TF CSIRT Trusted Introducer. Po ashtu është planifikuar, miratimi i ligjit të ri për sigurinë kibernetike nga Kuvendi në përputhje të plotë me direktivën NIS2 të BE-së.⁸¹	Qershor 2026-2027
---	------	--	--	-------------------

75 Raporti për Vendin 2024, fq.70.

76 Po aty, fq.14.

77 Shih më shumë në, <https://kryeministri.rks-gov.net/en/blog/the-state-training-center-for-cyber-security-is-inaugurated/>

78 Shih artikullin e BIRN në, <https://rb.gy/nef04z>

79 Shih më shumë në, <https://rb.gy/q3iesb>

80 Agjenda e Reformave Evropiane, fq.14.

81 Po aty, fq. 128.

4. Forcimi i kapaciteteve të sigurisë kibernetike në rajonin e Ballkanit Perëndimor përmes bashkëpunimit me Agjencinë e Bashkimit Evropian për Sigurinë Kibernetike - ABESK (ENISA)	2021-2024	Plani i veprimit kërkon forcimin e sigurisë kibernetike në Ballkanin Perëndimor përmes bashkëpunimit me Agjencinë e Bashkimit Evropian për Sigurinë Kibernetike (ENISA) duke përmirësuar Ekipet e Reagimit ndaj Incidenteve të Sigurisë Kompjuterike (CSIRTs), trajnimit teknik dhe përmirësimit të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit për të mbrojtur infrastrukturën kritike. Në maj të vitit 2023, BE-ja filloi "Programin e Punëve të Brendshme të BE-së në Kosovë", një iniciativë e rëndësishme që synon forcimin e përafrimit të sektorëve të punëve të brendshme të Kosovës me standardet evropiane dhe praktikën më të mira. Programi synon të adresojë fushat kritike të reformës në Kosovë, duke përfshirë mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe sigurinë kibernetike. Projekti ofron ndihmë për Ministrinë e Punëve të Brendshme në identifikimin dhe përcaktimin e infrastrukturave kritike kombëtare dhe evropiane, si dhe mbështetje në zhvillimin e planeve të sigurisë së operatorëve. Dhe synon të përafrojë kornizën ligjore dhe institucionale të Kosovës me standardet e BE-së.⁸²	n/a
5. Rritja e qëndrueshmërisë së hapësirës kibernetike në BP përmes rritjes së pjesëmarrjes së komunitetit të biznesit në forcimin e kapaciteteve të sigurisë kibernetike në BP	2022-2023	Në Kosovë, Ligji i miratuar për sigurinë kibernetike parashikon që Agjencia e Sigurisë Kibernetike, e krijuar me këtë Ligj, do të krijojë një platformë komunikimi me qytetarët dhe bizneset që do të jetë në dispozicion 24/7 për raportimin e incidenteve kibernetike.⁸³ Gjithashtu, komuniteti i bizneseve dhe shoqëria civile do të përfaqësohen në Këshillin Shtetëror për Sigurinë Kibernetike, i cili është një organ i pavarur këshillimor i përbërë nga të gjithë aktorët.⁸⁴ Lidhur me nivelin rajonal, në Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike të Kosovës 2023-2027, parashikohet rritja e pranisë së Kosovës në organizatat dhe forumet ndërkombëtare dhe rajonale për sigurinë kibernetike. Për më tepër, promovimi i bashkëpunimit kombëtar në të gjithë sektorët dhe pozicionimi i Kosovës si një aktor kompetent për bashkëpunim ndërkombëtar në të dy nivelet rajonale dhe globale.⁸⁵	Në Agjendën e Reformave Evropiane, është paraparë, krijimi i një Grupi Punues Qeveritar (GPQ) i dedikuar për të siguruar përputhshmërinë me kutinë e mjeteve të sigurisë kibernetike të BE-së 5G. GPQ-ja do të mandatohet zyrtarisht me vendim të qeverisë. Ky grup do të përfshijë përfaqësues nga ministrinë përkatëse të qeverisë, autoritetet rregullatore, operatorët e telekomit, ekspertët e sigurisë kibernetike, akademinë dhe aktorë të tjerë kryesorë.⁸⁶

82 Faqja zyrtare e BE-së, BE fillon Programin e Punëve të Brendshme të Kosovës për Forcimin e Bashkëpunimit dhe Sundimit të Ligjit në Kosovë, https://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/eu-launches-kosovo-home-affairs-programme-strengthen-cooperation-and-rule-law-kosovo_en?s=321

83 Ligji i Kosovës për Sigurinë Kibernetike Komisionit Evropian në, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=70933>

84 Po aty.

85 Strategjia Kombëtare e Kosovës për Sigurinë Kibernetike 2023-2027 në, <https://shorturl.at/2t0NY>

86 Agjenda e Reformave Evropiane, fq.47.

SHTOJCË 2

1. Të dhëna të detajuara për zbatimin e Planit të Përbashkët të Veprimit të Agjendës së Gjelbër/Dekarbonizimi dhe përfshirja në Agjendën e Reformave Evropiane

TABELA 1.2: AGJENDA E GJELBËR/DEKARBONIZIMI – AGJENDA E REFORMAVE EVROPIANE– PLANI I VEPRIMIT

Aktiviteti	Afati kohor	Ecuria (politikat, aktivitetet)	Aktiviteti në Planin e Veprimit të Agjendës së Reformës Evropiane	Afati kohor në Agjendën e Reformave Evropiane
1. Harmonizimi me Ligjin e BE-së për Klimën me një vizion për arritjen e objektivave të neutralitetit të klimës deri në vitin 2050	2025	Komisioni Evropian ka evidentuar që Kosova është në një fazë të hershme të përgatitjes në fushën e klimës dhe ka bërë përparim të kufizuar, me miratimin e Ligjit për ndryshimet klimatike në dhjetor 2023 si zhvillimi i vetëm i rëndësishëm.⁸⁷ Ky Ligj është pjesërisht në përputhje me Rregulloret dhe Direktivën e BE-së për Qeverisjen e Energjisë dhe Klimës, monitorimin e emetimeve të gazrave serrë, dhe tregtimin e lejimeve të emetimeve.⁸⁸	n/a	

⁸⁷ Raporti për Vendin 2024, fq.18.

⁸⁸ Shih Ligjin në, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85112>

Vendosja e qëllimeve të energjisë dhe klimës deri në vitin 2030	2022	Kosova i ka vendosur disa objektiva për energjinë dhe klimën në Strategjinë e Kosovës për Energjinë 2022-2031, si më poshtë: -Shpërndarja dhe konsumi i energjisë nga burimet e ripërtitshme synohet që deri në vitin 2030 të jetë 32%. Objektivi i Kosovës në këtë aspekt është më i ulëti krahasuar me objektivat e vendosura nga vendet e tjera të rajonit.⁸⁹ -Pjesa maksimale e konsumit të energjisë primare (energji primare në Kosovë rrjedh nga qymyri) deri në vitin 2030 synon të jetë 2.70 Mto (milion ton naftë ekuivalente).⁹⁰ -Pjesa maksimale e konsumit përfundimtar të energjisë në vitin 2030 synohet të jetë 1.80 Mto (milion ton naftë ekuivalente). -Synimi i Kosovës për emetimet e gazrave serrë në krahasim me nivelet e vitit 2016 dhe emetimet absolute në vitin 2030 synon të reduktohet me 16.3%. Ky objektivi është më i ulëti në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Përveç kësaj, qëllimi është të emetohen vetëm 8.95 MtCO₂ (milion tonë metrikë) gazra serrë në vitin 2030, që është më i lartë krahasuar, për shembull, me Malin e Zi dhe Maqedoninë që synojnë të lëshojnë vetëm rreth 2 MtCO₂.⁹¹ Pas miratimit të Ligjit dhe hartimit të Planit legjislativ të akteve nënligjore, ka filluar puna në hartimin e legjislacionit sekondar që rrjedhin nga Ligji nr. 08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të BRE-ve. Deri me tani Udhëzimi për procesin e ofertimit konkurrues për dhënien e mbështetjes për energjinë e ripërtitshme, është miratuar me datë 17.12.2024, ndërsa 4 projekt udhëzime administrative janë draftuar dhe janë në pritje për dërgim në konsultim paraprak dhe publik.	Në Agjendën e Reformave, specifikohet që në draftin e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës, përcaktohen objektivat deri në vitin 2030 lidhur me reduktimin e CO₂, rritjen e pjesës së energjisë së ripërtitshme në konsumin final dhe rritjen e efikasitetit të energjisë. Kjo reformë thekson ofrimin e energjisë së pastër kryesisht përmes modernizimit dhe ndërtimit të infrastrukturës thelbësore për të përmbushur objektivat e vitit 2030 të vendosura në Takimin Ministror të Komunitetit të Energjisë në dhjetor 2022 dhe të inkuorpuara në Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës së Kosovës.⁹² Por, në këtë dokument tutje thuhet se, pavarësisht angazhimit për të përmbushur këto objektiva të vitit 2030 dhe për të përparuar drejt dekarbonizimit, Kosova përballlet me disa sfida. Këto sfida përfshijnë kapacitete të kufizuara njerëzore dhe profesionale, qasje të kufizuara në mekanizmat financiarë ndërkombëtarë dhe kufizime politike. Duke pasur parasysh këto sfida, veçanërisht në lidhje me kapacitetet dhe duke marrë parasysh resurset specifike natyrore dhe rrethanat politike, Kosova është në fazat fillestare të adresimit të përpjekjeve për dekarbonizimin. Prandaj, zbatimi i Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës do të fillojë me adresimin e parakushteve të nevojshme për ekzekutimin e suksesshëm të tij.⁹³	Dhjetor 2025
--	------	---	---	--------------

89 Faqja zyrtare e UNDP-së në, <https://climatepromise.undp.org/what-we-do/where-we-work/kosovo>

90 Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (KBR), Raporti i Zbatimit të Agjendës së Gjellbër 2022, fq.10 në, <https://shorturl.at/9swvD>

91 Po aty.

92 Agjenda e Reformave Evropiane, fq.51.

93 Po aty, fq.52.

3. Krijimi dhe zbatimi i Planeve të integruara të Energjisë dhe Klimës	2022	Me miratimin e Rregullores së Qeverisjes në Këshillin Ministror i Komunitetit të Energjisë 2021, zhvillimi dhe miratimi i Planeve të Integruara Kombëtare të Energjisë dhe Klimës (PIKEK) u bë një detyrim ligjor për Kosovën dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. PIKEK-ët janë një instrument i rëndësishëm për drejtimin e tranzicionit energjetik, përcaktimin e qëllimeve energjetike dhe klimatike të ekonomisë, si dhe politikat dhe masat për arritjen e tyre. Sipas Rregullores, draftet e PIKEK-ve duhet të paraqiten për shqyrtimin dhe opinionin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë deri në qershor 2023 dhe të miratohen deri në qershor 2024.⁹⁴ Kosova ende nuk ka përfunduar Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën i cili ka filluar të hartohet që nga viti 2018. I njëjti është dërguar zyrtarisht për komentim në Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë më 12 korrik 2023. Më 29 dhjetor 2023, SKE dërgoi komentet për draftin e PKEK-së, dhe nga 25-27 mars 2024 u mbajt një punëtori për rishikimin e tyre. Ekspertët e GIZ dhe GET kanë përpunuar këto komente në draftin e dokumentit. Nga maj deri në dhjetor 2024, drafti u vendos në konsultim publik.⁹⁵dhe⁹⁶ Ndonëse, planifikohej të miratohej në dhjetor 2024, kjo nuk u arrit. Edhe në Raportin për Vendin 2024, KE ka kërkuar nga Kosova që në vitin 2025, të miratojë sa më shpejt Planin e saj Kombëtar të Energjisë dhe Klimës, në përputhje me rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.⁹⁷	Agjenda e Reformave është në përputhje me kuadrin më të gjerë për qeverisjen e mjedisit, duke përfshirë Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës të Kosovës. Reformat e identifikuar nën Agjendën e Reformave janë në përputhje me Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës, duke u fokusuar në uljen e emisioneve të gazeve serrë dhe rritjen e përdorimit të energjisë së ripërtëritshme.⁹⁸	Dhjetor 2025
---	------	--	---	--------------

94 Po aty, fq.12.

95 Intervistë e KDI-së me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe përgjigjie me shkrim në maj-qershor 2024.

96 Shih në, <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42695>

97 Raporti për Vendin 2024, fq.17.

98 Po aty, fq.10.

4. Përgatitja dhe zbatimi i strategjive të adaptimit të ndryshimeve klimatike	2028	Një Strategji e Përshtatjes Klimatike nuk është miratuar ende në Kosovë. Hartimi i kësaj Strategjie pritej të fillonte në gjysmën e dytë të vitit 2024.⁹⁹ Megjithatë, ekzistojnë dokumente të përcaktuara që rregullojnë çështjet që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike. Në shkurt 2019, Qeveria e Kosovës në atë kohë miratoi Strategjinë për Ndryshimet Klimatike 2019-2028 dhe Planin e Veprimit 2019-2021, por i cili Plan tashmë duhet të përditësohet.¹⁰⁰	Investimet e planifikuara në kuadër të Agjendës së Reformës synojnë të sigurojnë zbatimin e duhur të ligjeve dhe procedurave të lidhura me mbrojtjen e mjedisit, përfshirë një Vlerësim Strategjik të Mjedisit (SEA) në fazat e politikës dhe planifikimit të strategjisë, një Vlerësim të Ndikimit Mjedisor dhe Social (ESIA) në nivel projekti, dhe konsultime publike. Për çdo veprim, Kosova do të duhet të vlerësojë mundësinë për rritjen e qëndrueshmërisë dhe zbutjen e rrezikut nga ndryshimet klimatike, duke aplikuar integrimin e ndryshimeve klimatike dhe mbrojtjen ndaj klimës.¹⁰¹
5. Harmonizimi me Sistemin e BE-së për Tregtimin dhe/ose futjen e instrumenteve të tjera të çmimit të karbonit	2024	Instrumentet e çmimit të karbonit nuk janë përfshirë ende në rajonin e Ballkanit Perëndimor, me përjashtim të Malit të Zi.¹⁰² As Kosova ende nuk ka krijuar një kornizë për mekanizmat e çmimeve të karbonit. Megjithatë, zhvillimi i këtyre skemave të çmimeve të karbonit aktualisht është duke u zhvilluar, mbështetur nga Komuniteti i Energjisë i BE-së.¹⁰³ Çmimi i karbonit është thelbësor për veprimin ndaj klimës dhe rritjen ekonomike në Ballkanin Perëndimor. Ai mund të reduktojë emetimet dhe tërheqë investime të pastra. Një qasje e koordinuar rajonale dhe zbatimi i kujdesshëm janë të rëndësishëm për të shmangur disavantazhet tregtare dhe për të siguruar politika efektive ndaj klimës.¹⁰⁴ Në Raportin për Vendin 2024, KE ka kërkuar nga Kosova që të zbatojë Ligjin për ndryshimet klimatike, veçanërisht kuadrin për monitorimin, raportimin, verifikimin dhe akreditimin e emisioneve të gazrave serrë, me qëllim të mundësimin të çmimit të karbonit për të përputhur kuadrin ligjor me sistemin e tregtimit të emisioneve të BE-së.¹⁰⁵ Në Strategjinë e Kosovës për Energjinë 2022-2031, thuhet se, në kuptimin afatgjatë, Kosova është e përkushtuar që të vendos një sistem të çmimit të karbonit dhe ta harmonizojë atë me nivelet e çmimeve EU ETS deri në vitin 2030, për shkak të nënshkrimit të Deklaratës së Sofjes për Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor.¹⁰⁶	n/a

99 Intervistë e KDI-së me përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturs, 24 nëntor 2023, Prishtinë.

100 Republika e Kosovës, "Strategjia për Ndryshime Klimatike 2019- 2028 dhe Plani i Veprimit 2019-2021" në, <https://shorturl.at/r8uY9>

101 Agjenda e Reformave Evropiane, fq.13.

102 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Zbatimit të Agjendës së Gjellbër 2022, fq.13.

103 Intervistë e KDI-së me përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturs, 24 nëntor 2023, Prishtinë.

104 Shih publikimin e Bankës Botërore "Raporti për Klimën dhe Zhvillimin e Shtetit 2024", qershor 2024 në, <https://shorturl.at/4APp1>

105 Raporti për Vendin 2024, fq.18.

106 Shih Strategjinë e Kosovës për Energji, fq.16, në <https://shorturl.at/RR96y>

6. Rritja e mundësive për krijimin e zgjidhjeve natyrore për zbutjen dhe adaptimin e ndryshimeve klimatike	2025	Zbatimi i qasjeve që integrojnë ekosistemet dhe natyrën më gjerësisht në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe masat për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë është ende i pamjaftueshëm dhe i fragmentuar në të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor.¹⁰⁷ Kosova është në faza të hershme në adresimin e sfidave mjedisore dhe klimatike, duke bërë progres të kufizuar në ligjet dhe strategjitë për menaxhimin e mbeturinave, cilësinë e ajrit dhe ujit dhe mbrojtjen e natyrës. Për t'u përmirësuar, Kosova duhet të integrojë zgjidhje të bazuara në natyrë, siç është rritja e riciklimit të mbeturinave, mbjellja e pemëve për të përmirësuar cilësinë e ajrit, menaxhimi i ujit, mbrojtja e habitateve natyrore dhe përdorimi i infrastrukturës së gjelbër për të adresuar ndotjen industriale. Këto zgjidhje mund të mbështesin strategjinë e Kosovës për klimën duke reduktuar emetimet e karbonit dhe duke rritur elasticitetin ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike.¹⁰⁸ Në këtë drejtim, Unioni Ndërkombëtar për Rruajtjen e Natyrës po zbaton një projekt të quajtur ADAPT në të gjitha vendet e rajonit. Ky projekt përdor zgjidhje të bazuara në natyrë për të rritur elasticitetin ndaj ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor. Ai synon të rrisë ndërgjegjësimin, të integrojë këto zgjidhje në politika dhe t'i zbatojë ato për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë. Duke filluar nga nëntori 2019 deri në tetor 2024 me një buxhet 2.48 milionë euro, projekti zbaton partneritete rajonale dhe lokale.¹⁰⁹ Në Raportin për Vendin 2024, thuhet se shpyllëzimi dhe prerja e paligjshme e pyjeve mbeten një çështje e rëndësishme shqetësimi.¹¹⁰ Po ashtu, nuk ka pasur përparim në harmonizimin e legjislacionit për menaxhimin e ujërave dhe përmbytjet me acquis-in e BE-së gjatë periudhës së raportimit.¹¹¹	Agjenda e Reformave të Kosovës tregon angazhim për parimin “mos shkakto dëm të rëndësishëm” duke marrë parasysh efektet e mundshme në përpjekjet për zbutjen dhe adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe parimin për parandalimin dhe kontrollin e ndotjes.¹¹² Investimet e planifikuara do të sigurojnë zbatimin e duhur të ligjeve dhe procedurave të lidhura me mbrojtjen e mjedisit, përfshirë një Vlerësim Strategjik të Mjedisit (SEA) në fazat e politikës dhe planifikimit të strategjisë, një Vlerësim të Ndikimit Mjedisor dhe Social (ESIA) në nivel projekti, dhe konsultime publike. Për çdo veprim, Kosova do të duhet të vlerësojë mundësinë për rritjen e qëndrueshmërisë dhe zbutjen e rrezikut nga ndryshimet klimatike, duke aplikuar integrimin e ndryshimeve klimatike dhe mbrojtjen ndaj klimës. Veprimet e propozuara do të jenë në përputhje me parimin e veprimit parandalues dhe parimin “ai që ndot, paguan”. Miratimi i legjislacionit dytësor për zbatimin e Ligjit për ndryshimet klimatike do të jetë kyç për të përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e autoriteteve të Kosovës në marrjen e masave për zbutjen e pasojave të ndryshimeve klimatike, përfshirë kuadrin ligjor për mundësimin e krijimit të Monitorimit, Raportimit, Verifikimit dhe Akreditimit (MRVA) dhe zbatimin e tij të plotë, si dhe përmbushjen e obligimeve të Kosovës ndaj marrëveshjeve ndërkombëtare.¹¹³	Dhjetor 2027
---	------	--	---	--------------

107 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Zbatimit të Agjendës së Gjelbër 2022, fq.14.

108 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2023, fq.112-117.

109 Shih më shumë rreth projektit ADAPT në, <https://shorturl.at/VNPaK>

110 Raporti për Vendin 2024, fq.83.

111 Po aty.

112 Agjenda e Reformave Evropiane, fq.13.

113 Po aty, fq.13.

7. Garantim i pjesëmarrjes së ekonomive të BP-së në Paktin Evropian të Klimës apo të konsiderohet krijimi i mekanizmave të ngjashëm.	2022	Pakti Evropian për Klimën është një nismë e Bashkimit Evropian që synon të angazhojë qytetarët, komunitetet dhe organizatat në veprime konkrete për të luftuar ndryshimet klimatike. Ai promovon ndërgjegjësimin, ndan informacione dhe inkurajon pjesëmarrjen e gjerë për të arritur objektivat e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane. ¹¹⁴	n/a	
8. Shqyrtim dhe rishikim, kur është e nevojshme, i të gjitha rregulloreve përkatëse për të mbështetur dekarbonizimin gradual të sektorit të energjisë.		Megjithëse dekarbonizimi parashikohet në Strategjinë e re të Energjisë të miratuar në mars 2023, Qeveria e Kosovës ende nuk ka hartuar një Strategji të Dekarbonizimit, e cila është përmendur si mangësi edhe në Raportin e KE-së për Kosovën 2023.¹¹⁵ Sa i përket rishikimit të legjisllacionit, Projektligji për Energjinë dhe Projektligji për Energjinë Elektrike, kanë kaluar procesin e diskutimit paraprak, publik dhe komentimin nga ana e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Gjithashtu është marrë Opinioni për vlerësimin e ndikimit Financiar nga Ministria e Financave, dhe Opinioni i Përputhshmërisë me legjisllacionin e BE-së nga Zyra e Kryeministrit. Veç kësaj, janë në proces të përgatitjes draftet fillestare edhe Projektligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Projektligjit për Eficiencën e Energjisë.¹¹⁶	Politika e dekarbonizimit është njëra nga nënfushat e Agjendës së Reformës Evropiane. Në kuadër të saj, është planifikuar, rishikimi dhe miratimi i paketës së akteve nënligjore për zbatimin e ligjit për ndryshimet klimatike, duke përfshirë kornizën legjisllative për të mundësuar krijimin e Monitorimit, Raportimit, Verifikimit dhe Akreditimit (MRVA-së). ¹¹⁷	Dhjetor 2026
9. Përgatitja e vlerësimit të ndikimit socio-ekonomik të dekarbonizimit në nivelin e ekonomive individuale dhe në nivel rajonal		Ngjashëm me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, Kosova ka filluar të vlerësojë ndikimin socio-ekonomik të dekarbonizimit në nivel ekonomik individual përmes një projekti të mbështetur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Qëllimi është që përfundimisht të zhvillohet një plan veprimi që do të përfshijë rekomandime për reformat e kërkuara të politikave për të adresuar këtë çështje. ¹¹⁸	n/a	

114 Shih, https://climate-pact.europa.eu/about_en

115 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2023, fq.116.

116 Nga komunikimi me shkrim mes KDI-së dhe Ministrisë së Ekonomisë, shkurt 2025.

117 Agjenda e Reformave Evropiane, fq.129.

118 Intervistë e KDI-së me përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, 24 nëntor 2023, Prishtinë.

Prioritizimi i efijencës së energjisë dhe përmirësimit të saj në të gjithë sektorët	Në vazhdimësi	Në Raportin për Vendin 2024, për sa i përket efikasitetit të energjisë, është arritur përparim i mirë në zbatimin e masave për efikasitetin e energjisë në sektorët rezidencial dhe privat si pjesë e Paketës së Mbështetjes për Energjinë të financuar nga BE. Modeli financiar për investimet në sektorin rezidencial është në zhvillim. Kosova ende duhet të miratojë Ligjin e ri për efikasitetin e energjisë. Ligji i ndryshuar për performancën energjetike të ndërtesave u miratua në maj 2024. Për të rritur efikasitetin e energjisë siç është parashikuar në strategjinë e energjisë, Kosova duhet të mobilizojë financime shtesë dhe të forcojë kapacitetin institucional për të zbatuar dhe monitoruar kursimet e lidhura me to.¹¹⁹ Në kuadër të Strategjisë së Energjisë, rritja e efijencës së energjisë synon kufizimin e konsumit të energjisë në 1877 ktoe deri në vitin 2031.¹²⁰ Për rritjen e efijencës së energjisë, po implementohen masa në 12 objekte publike, të ndara në dy lote: LOT 1 – Përfshin 6 objekte spitalore (Pediatria, Kirurgjia, Onkologjia, Psikiatria e fëmijëve, Intenziva Psikiatrike dhe ura lidhëse ORL-Kirurgji). Puna përfundoi në gusht, ndërsa pranimi teknik i punimeve u krye në shtator. Vlera: 1.16 milionë €, periudha e zbatimit: 2022-2024. LOT 2 – Përfshin 6 objekte, përfshirë 3 spitale (Spitali i Psikiatrisë në Gjakovë, Spitali i Fizioterapisë dhe Spitali i Morgut në Prizren) dhe 3 objekte administrative. Vlera: 954,345 €, periudha e zbatimit: 2023-2024.¹²¹	Në Agjendën e Reformave Evropiane thuhet se, përfitimet shoqërore të përmirësimit të efikasitetit energjetik të ndërtesave janë të forta, por ka shumë pengesa për zbatimin e tij. Më shumë se gjysma e ndërtesave në Kosovë janë mbi 45 vjet të vjetra dhe kërkojnë investime të mëdha për të ruajtur vlerën. Zbatimi i dobët i standardeve të efikasitetit energjetik dhe mungesa e kapaciteteve dhe materialeve janë disa nga sfidat kryesore. Barrierat përfshijnë probleme ligjore, financiare dhe teknike që ndikojnë të gjithë sektorët e ndërtimit. Nëse këto pengesa nuk adresohen, ato mund të rrisin kostot e huamarrjes dhe ta bëjnë përmirësimin e efikasitetit energjetik më pak tërheqës ekonomikisht, veçanërisht për banesat me të ardhura të ulëta.¹²²	
11. Transpozimi dhe zbatimi i plotë i Direktivës për Performancën Energjetike të Ndërtesave	2023	Siç u cek më lartë, në maj 2024, Kosova ka miratuar Ligjin për performancën energjetike të ndërtesave. Mirëpo në tekstin e ligjit thuhet se: Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2010/31/BE për Performancën Energjetike të Ndërtesave dhe Direktivën (BE) 2018/844 që e Ndryshon Direktivën 2010/31/BE për Performancën Energjetike të Ndërtesave.¹²³ Aktivitetet për të forcuar ekspertizën dhe mjetet për certifikimin e ndërtesave janë në vazhdimësi, duke përfshirë regjistrin e ri dhe softuerin e certifikimit.¹²⁴ Megjithatë, Strategjia e Rinovimit të Ndërtesave dhe Plan i për ndërtesat me energji gati zero ende nuk janë miratuar.¹²⁵	Në Agjendën e Reformave Evropiane, në kuadër të Efijencës së Energjisë, është vendosur si një nga hapat, zbatimi i Direktivës së Efijencës së Energjisë dhe Direktivës së Performancës së Energjisë në Ndërtesa.¹²⁶ Si një nga synimet është vendosur, zbatimi i Strategjisë së miratuar për Rinovimin e Ndërtesave dhe plani për ndërtesat me energji pothuajse zero që të jetë në rrugën e duhur nëpërmjet rinovimit të ndërtesave publike ekzistuese në përputhje me objektivin vjetor të rinovimit prej 3% (Direktiva për Efijencën e Energjisë).¹²⁷	Qershor 2026

119 Raporti për Vendin 2024, fq.17.

120 Intervistë e KDI-së me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe përgjigje me shkrim gjatë muajit maj-qershor 2024.

121 Nga komunikimi me shkrim i KDI-së me Ministrinë e Ekonomisë, shkurt 2025.

122 Agjenda e Reformave të Kosovës, fq.57.

123 Shih Ligjin, Nenin 1 në, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=92131>

124 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Zbatimit të Agjendës së Gjellbër 2022, fq.24.

125 Po aty.

126 Agjenda e Reformave Evropiane, fq.24.

127 Po aty, fq.130.

12. Mbështetja e programeve për rinovimin e ndërtesave private dhe publike dhe sigurimi i fondeve të për-shtatshme

Në vazhdimësi

Edhe gjatë vitit 2024 Kosova ka vazhduar me projektet e renovimit për ndërtesat residen-ciale dhe publike me mbështetje nga qeveria dhe donatorët. Gjatë vitit 2024, Fondi për Efiçencën e Energjisë ka përfunduar projektet për 85 ndërtesa publike dhe ka paguar 7.8 mil-ionë euro për 2, 219 shtëpi rezidenciale. Ndërsa në proces janë, 17 ndërtesa publike dhe 785 shtëpi. Investimet synojnë të reduktojnë përdorimin e energjisë deri në 70%.¹²⁸

Nga investimet në vlerë prej €13,450,159.75 euro për pajisje efikase dhe sisteme të energ-jisë ripërtëritshme deri më tani kanë përfituar 31,487 konsumatorë familjar.¹²⁹

Në Agjendën e Reformave Evropi-ane, thuhet se Kosova angazho-het të zbatojë Strategjinë e Renovi-mit të Ndërtesave dhe të rrisë shkallën totale të rinovimit të ndër-tesave dhe ndriçimit të rrugëve.¹³⁰

Stoku aktual i ndërtesave publike është në 935 ndërtesa publike brenda bazës së të dhënave, që do të thotë se me normën 3% të rinovimit, Kosova synon të ketë 28 ndërtesa publike të rinovuara çdo vit. Derisa, brenda vitit 2024 plani-fikohej të lëshoheshin dy certifika-ta të performancës si pilot për ndërtesat publike, gjatë vitit 2025, synohet të lëshohen 40 certifikata të të tilla.¹³¹

Si target Kosova ka vendosur që rritja e normës totale të rinovimit të ndërtesave dhe ndriçimit të rrugëve të arrijë 0.5 milion metra katrorë të rinovuara, nga 0.4 mil-ionë sa është aktualisht.¹³²

128 Shih, <https://www.facebook.com/photo/?fbid=1057424586189534&set=pcb.1057424762856183>

129 Nga komunikimi me shkrim i KDI-së me Ministrinë e Ekonomisë, shkurt 2014.

130 Agjenda e Reformave Evropiane, fq.28.

131 Po aty, fq.56.

132 Po aty, fq.130.

13. Rritja e pjesës së burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe krijimi i kushteve të nevojshme të investimit

Në vazhdimësi

Kosova iu afrua përmbyshjes së objektivit të saj të vitit 2020 për përdorimin e energjisë së ripërtëritshme në konsumin përfundimtar bruto të energjisë. Objektiva të reja janë miratuar nga Këshilli i Ministrorëve i Komunitetit të Energjisë në dhjetor 2022.¹³³

Në Raportin për Vendin 2024, thuhet se Kosova ka një nivel përgatitjeje në fushën e energjisë. Ka bërë disa përpjekje në këtë fushë duke miratuar Ligjin për promovimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në prill 2024, nisjen e lidhjes së tregut të energjisë me Shqipërinë, përfundimin me sukses të ankandit të parë të energjisë diellore dhe duke bërë investime të mëtejshme në rritjen e efikasitetit të energjisë në ndërtesat publike dhe rezidenciale. Megjithatë, Kosova mbetet shumë e varur nga centralët e energjisë me qymyr të vjetruara dhe ka nevojë të përshejtojë implementimin e burimeve të energjisë së ripërtëritshme në përputhje me strategjinë e saj të re energjetike.¹³⁴

Pas miratimit të Ligjit për promovimin e burimeve të ripërtëritshme dhe hartimit të Planit legjislativ të akteve nënligjore, ka filluar puna në hartimin e legjislacionit sekondar që rrjedhin nga ky ligj. Deri më tani Udhëzimi për procesin e ofertimit konkurrues për dhënie të mbështetjes për energjinë e ripërtëritshme, është miratuar më 17 dhjetor 2024, ndërsa 4 projekt udhëzime administrative janë draftuar dhe janë në pritje për dërgim në konsultim paraprak dhe publik.¹³⁵

Sa i përket projekteve investive, në maj 2023, Kosova lansoi ankandin e parë solar me kapacitet 100 MW, me konsorciumin "Orlati" që ofroi çmimin 48.88€/MWh. Marrëveshja për zhvillimin e projektit u nënshkrua në maj 2024 dhe ndërtimi pritet të fillojë pas marrjes së lejeve. Po ashtu, u miratua ankandi prej 100 MW energji nga era në nëntor 2024, dhe procesi i aplikimeve është në vazhdim deri në shkurt 2025. Projekte të tjera që janë në zhvillim:

- **Solar4Kosovo:** 100 MW energji diellore me marrëveshje të nënshkruara me KfW dhe EIB.
- **Solar 4 Kosova (50 MW):** Energjia diellore për ngrohje në lagje të reja.
- **Sistemi i Ruajtjes së Energjisë (170 MW):** Projekt për ruajtjen e energjisë me vlerë 236.67 milion \$, me themelimin e "Korporatës së Ruajtjes së Energjisë".¹³⁶

Kosova e ka vendosur si synim, përmirësimin e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së energjisë duke reformuar sektorin e energjisë, duke kaluar në burimet e ripërtëritshme dhe duke shfrytëzuar potencialin e kursimit të energjisë.¹³⁷ Në këtë drejtim, synon të paktën 100 MW kapacitete të reja të energjisë së ripërtëritshme diellore të instaluar dhe të lidhura, dhe kontrata të nënshkruara për të paktën 150 MW kapacitete të reja të energjisë së ripërtëritshme, në përputhje me Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën dhe objektivat e rënë dakord brenda Komunitetit të Energjisë.¹³⁸

Për të arritur objektivat e saj strategjike për një pjesëmarrje prej 35% të energjisë ripërtëritshme në energjinë elektrike të konsumuar deri në vitin 2031, Kosova duhet të përshejtojë implementimin e projekteve të energjisë ripërtëritshme dhe të nisë menjëherë ankandin e parë të erës, për të cilin kriteret paraprake u publikuan në korrik 2024 dhe që do të jetë me kapacitet prej 75 MW. Mësimet e nxjerra nga ankandi i parë pilot të energjisë diellore, i cili pati vonesa të konsiderueshme, duhet të merren parasysh në proceset e ardhshme të tenderimit konkurrues.¹³⁹

133 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raportin i Zbatimit të Planit të Veprimit për Agjendën e Gjellbër 2022, fq.26.

134 Raporti për Vendin 2024, fq.17.

135 Nga komunikimi me shkrim mes KDI-së dhe Ministrisë së Ekonomisë, shkurt 2025.

136 Po aty.

137 Po aty, fq.9.

138 Agjenda e Reformave Evropiane, fq.130.

139 Po aty, fq.81.

14. Zvogëlimi dhe eliminimi gradual i subvencioneve të qymyrit, në përputhje të plotë me rregullat e ndihmës shtetërore.	Në vazhdimësi	Prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë mbështetet shumë në termocentralet me qymyr. Më shumë se 90% e energjisë elektrike prodhohet nga dy termocentralet të vjetruara, jo të besueshme dhe shumë ndotëse të linjitet, të cilat qeveria planifikon t'i rinovojë.¹⁴⁰ Strategjia e Energjisë parashikon zëvendësimin gradual të përdorimit të qymyrit deri në vitin 2050, nëpërmjet tre objektivave strategjikë a) uljen graduale të çmimit të karbonit, b) nxitjen e energjisë së ripërtëritshme në përzierjen e prodhimit të energjisë elektrike, c) nxitjen e përdorimit të energjisë së ripërtëritshme për ngrohje.¹⁴¹ Në vitin 2022, Kosova prezantoi për herë të parë subvencione për investime në burime më efikase dhe më pak ndotëse, gjë që u pa si një pikë kthese e mirë.¹⁴² Që nga viti 2012, Kosova nuk ofron subvencione për qymyr. Ndërsa, përdorimi i qymyrit është i ndaluar vetëm në institucionet shkollore dhe shtëpiake.¹⁴³ Megjithatë, qymyri vazhdon të përdoret për qëllime ngrohjeje. Në Raportin për Vendin 2024, KE thekson që, implementimi i masave që ndalojnë përdorimin e qymyrit për ngrohje ende duhet të zbatohet.¹⁴⁴	n/a
15. Garantimi i pjesëmarrjes në Nismën për Mbështetjen e Rajoneve të Qymyrit në Tranzicion në Ballkanin Perëndimor		“Iniciativa për Rajonet e Qymyrit në Tranzicion në Ballkanin Perëndimor dhe Ukrainë” (2020-2023) ka synuar të ndihmojë rajonet e varura nga qymyri në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Ukrainë në kalimin drejt një ekonomie neutrale ndaj karbonit. E menaxhuar nga Komisioni Evropian dhe partnerët, ajo ka ofruar dialog rajonal, ngritje kapacitetesh dhe asistencë teknike. Iniciativa mbështeti objektivat e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane për neutralitetin klimatik, me një përpjekje të re të planifikuar për vitin 2024 për të vazhduar këto veprime në Ballkanin Perëndimor.¹⁴⁵	n/a

140 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2023, fq.68.

141 Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës, fq. 8.

142 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2023, fq. 115.

143 Intervistë e KDI-së me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, 27 nëntor 2023, Prishtinë.

144 Raporti për Vendin 2024, fq.82.

145 Shih më shumë në, <https://shorturl.at/xH1jj>

16. Zhvillimi i programeve për të adresuar problemin e varfërisë energjetike dhe financimin e skemave për rindërtimin e familjeve dhe sigurimin e standardeve themelore të jetesës

Nivelet e varfërisë energjetike në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor janë ndër më të lartat në Evropë. Varfëria energjetike ndodh kur një familje duhet të zvogëlojë konsumin e saj të energjisë në një shkallë që ndikon negativisht në shëndetin dhe mirëqenien e banorëve.

Sipas EUROSTAT, pjesa e familjeve në Komunitetin e Energjisë të paafta për të mbajtur shtëpitë në mënyrë adekuate të ngrohta është shumë më e lartë se mesatarja e BE-së, me nivelet më të larta në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut, e ndjekur nga Mali i Zi dhe Serbia.¹⁴⁶

Sipas një publikimi të INDEP në nëntor të vitit 2024, i cili citon një studim të Komunitetit të Energjisë, 40% e familjeve në Kosovë nuk arrijnë të mbajnë ngrohtësinë e duhur në shtëpitë e tyre, që është shifra më e lartë në rajon.¹⁴⁷

Ngjashëm edhe një publikim i GIZ i vitit 2023, ka gjetur se varfëria energjetike në Kosovë është një problem i madh që prek rreth 40% të familjeve, veçanërisht ato me të ardhura të ulëta, sidomos komunitetet Roma, Ashkali, dhe Egjiptian. Familjet në varfëri energjetike shpenzojnë një pjesë të madhe të të ardhurave për energji, dhe shpesh nuk kanë mundësi të paguajnë faturat ose të ngrohjin shtëpitë gjatë dimrit.

Ndërkohë që ligjet aktuale përfshijnë disa masa për të mbrojtur konsumatorët në nevojë, ato ende nuk janë të mjaftueshme për të adresuar rritjen e kostove të energjisë dhe për të përmirësuar standardet e jetesës dhe shëndetit të qytetarëve.¹⁴⁸

Të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën, tashmë kanë zbatuar disa masa afatshkurtra që synojnë zbutjen e varfërisë energjetike.¹⁴⁹ Edhe pse efektive në planin afatshkurtër, ato rezultojnë të pamjaftueshme për zbutjen afatgjatë të varfërisë energjetike.

Top of Form

Për më tepër, Paketa e re e Mbështetjes së Energjisë e BE-së, me vlerë 1 miliard euro në grante, ishte një rezultat i rëndësishëm i Deklaratës së Tiranës.¹⁵⁰ Sipas kësaj pakete dhe nëpërmjet IPA III, BE-ja siguroi 500 milionë euro grante për mbështetje të menjëhershme për familjet në nevojë.¹⁵¹

Duke filluar nga viti 2022, Kosova filloi projekte në dy faza për të financuar subvencionimin e pajisjeve me efikasitet energjetik për familjet. Kjo iniciativë synon të zvogëlojë drejtpërdrejt kërkesën për energji duke siguruar një subvencion prej 40% për këto blerje.¹⁵²

Në janar të vitit 2024 Ministria e Financave njoftoi që ka nisur subvencionimi i energjisë elektrike për familjet e cënueshme i mbështetur nga BE, nga i cili do të përfitojnë 40,620 familje.¹⁵³

Në Agjendën e Reformave Evropiane, theksohet që, përpjekjet për të përmirësuar efikasitetin e energjisë dhe për të promovuar energjinë e ripërtëritshme kanë përfshirë iniciativë të tilla si Fondin për Eficiencë të Energjisë, i cili mbështet rinovimin e ndërtesave publike dhe subvencionimin e pajisjeve efikase të ngrohjes për familjet.¹⁵⁴

Në këtë dokument përmendet edhe Programi për Konsumatorët në Nevojë për 2023-2024, që është një iniciativë pilot që synon të mbështesë rreth 60,000 familje të cënueshme në Kosovë, duke subvencionuar kostot e shërbimeve esenciale si energjia elektrike. Ky program ka si qëllim që të sigurojë që kostoja e energjisë elektrike të mos ndikojë negativisht në të ardhurat e disponueshme të këtyre familjeve, duke i mundësuar atyre të përmbushin nevojat e tyre themelore. Ky është një program që mund të rishikohet dhe të ketë ndryshime të mundshme në të ardhmen, përfshirë përshtatjen e pragut të të ardhurave. Hapi i fundit i këtij programi parashikohet të përfundojë deri në dhjetor 2026.¹⁵⁵

Dhjetor
2026

146 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Agjenda e Gjelbër për Raportin e Zbatimit të Planit të Veprimit të BP 2022, fq.32.

147 Shih Publikimin e INDEP në, <https://indep.info/wp-content/uploads/2024/11/Varferia-energjetike.pdf>

148 Shih më shumë në, <https://www.giz.de/en/downloads/giz2023-en-factsheet-energy-poverty.pdf>

149 Po aty, fq.32.

150 Samiti BE-Ballkani Perëndimor, Deklarata e Tiranës, 6 dhjetor 2022.

151 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Zbatimit të Planit të Veprimit për Agjendën e Gjelbër 2022, fq.32.

152 Ministria e Ekonomisë, faqja zyrtare në, <https://me.rks-gov.net/blog/zgjatet-afati-i-aplikimit-per-fazen-1-per-subvencionim-te-eficiences-se-energjise/>

153 Shih më shumë në Ministria e Financave, faqja zyrtare në Facebook në <https://shorturl.at/jzegb>

154 Agjenda e Reformave Evropiane, fq.12.

155 Agjenda e Reformave të Kosovës, fq.54.

17.Mbështetja e zhvillimit të infrastrukturës inteligjente, promovimi i nxitjes së teknologjive novatore (si transporti pa bileta, inteligjenca artificiale, bileta multimodale e pasagjerit, lëvizshmëria si shërbim, aplikacionet e kufirit të kufirit, korridoret 5G, etj)

KE, në Raportin për Vendin 2024, thekson se Kosova ka bërë disa përparime në zhvillimin e një sistemi inteligjent të transportit, duke përfshirë miratimin e një plani veprimi për transportin multimodal, miratimin e strategjisë për sistemin inteligjent të transportit dhe hapjen e korridoreve të reja ajrore me Shqipërinë. Megjithatë, duhen ndërmarrë hapa të mëtejshëm për t'u rreshtuar me standardet e BE-së. Veprimet kryesore përfshijnë, përmirësimin e mirëmbajtjes së rrugëve, përshtatjen e legjislacionit hekurudhor me BE-në dhe sigurimin e burimeve të mjaftueshme për zbatimin e strategjisë ITS. Gjithashtu, Kosova duhet të harmonizojë ligjet e transportit me të drejtat e pasagjerëve të BE-së.¹⁵⁶

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) po asiston në përmirësimin e sistemit të transportit urban në Prishtinë duke siguruar një kredi deri në 10 milionë euro në kuadrin e Qyteteve të Gjelbra. Projekti do të prezantojë për herë të parë teknologjinë e autobusëve elektrikë në Kosovë, me gjashtë autobusë elektrikë.¹⁵⁷

Kosova në prill 2023 ka siguruar qasje 100% në internet në territorin e saj duke shënuar shkallën më të lartë të mbulimit në Evropë.¹⁵⁸

Në nivel rajonal, Kosova dhe Shqipëria kanë nënshkruar memorandumin për krijimin e korridorit digjital të 5G. Ky rrjet premtan transmetim shumë më të shpejtë të të dhënave përmes internetit, rreth 100 herë më shpejt se teknologjia aktuale 4G. Ky memorandum është harmonizuar me marrëveshjen e arritur në Uashington.¹⁵⁹

Në shkurt të vitit 2024 është shënuar një hap tjetër drejt digjitalizimit të Trafikut Urban në kryeqytet ku është bërë lidhja me internet në autobusët e Trafikut Urban, duke iu mundësuar udhëtarëve të shfrytëzojnë falas shërbimet e internetit. Kostoja e këtij shërbimi është 2 mijë e 500 euro në muaj, ndërsa synimi është për ta bërë sa më atraktiv transportin publik.¹⁶⁰

Në muajin maj 2024 Ministria e Ekonomisë dhe Komuna e Gjilanit, kanë nënshkruar Marrëveshjen e mirëkuptimit, për realizimin e Projektit "Pilotimi i konceptit të Smart City (Neutral Host)" i me bashkëfinancim që ka vlerën 550,000,00 euro. Ky projekt do të adoptoj teknologji të reja, shfrytëzimin eficient të energjisë elektrike, sistemin digjital për menaxhimin e trafikut, mbeturinave dhe ofrimin e shërbimeve digjitale komunale.¹⁶¹

Në instrumentin e Reformës Evropiane, është përfshirë edhe vendosja e Sistemit Inteligjent të Transportit (ITS) dhe e-transportit të përafruar plotësisht me Direktivën ITS.¹⁶²

Po ashtu, parashihet, ndërtimi i stacioneve dhe strehimoreve të digjitalizuara të autobusëve në rrugët nacionale dhe rajonale të Kosovës është në përputhje me objektivat e Agjendës së Reformave të Kosovës, duke përmirësuar infrastrukturën e transportit, duke promovuar praktikën e transportit të qëndrueshëm, duke rritur qasjen në shërbime dhe mundësi, duke integruar teknologjitë inteligjente, duke përmirësuar përvojën e pasagjerëve, duke mbështetur rritjen ekonomike dhe duke kontribuar në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.¹⁶³

156 Raporti për Vendin, fq.70.

157 Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, faqja zyrtare në internet, <https://shorturl.at/VPa7y>

158 Intervistë e KDI-së me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, 27 nëntor 2023, Prishtinë.

159 Marrëveshja Shqipëri-Kosovë për korridorin 5G, <https://shorturl.at/udr0C>.

160 Trafiku Urban, faqja zyrtare në <https://trafikurban-pr.com/2022/ëi-fi-falas/>

161 Shih lajmin në faqen zyrtare të Ministrisë së Ekonomisë, në <https://shorturl.at/LhVNS>

162 Instrumenti i Reformës Evropiane, fq.25.

163 Po aty, fq.99.

18. Zbatimi i Planit Rajonal të Veprimit për Reformën Hekurudhore	Raporti për Vendin 2024, thekson se Kosova ka bërë përpertime të kufizuara në zbatimin e Acquis-it të transportit hekurudhor. Agjencia Rregullatore e Hekurudhave, e cila ka funksionet e trupit rregullator, licencimit dhe autoritetit për sigurinë dhe ndërveprueshmërinë, ka publikuar disa akte ligjore kryesisht lidhur me specifikimet teknike të ndërveprueshmërisë. Tregu i shërbimeve të transportit hekurudhor është i hapur dhe funksional. U krijua një Trup Hetues Kombëtar, i cili raporton drejtpërdrejt te Kabineti i Kryeministrit. Megjithatë, legjislati i hekurudhor ende duhet të harmonizohet plotësisht me shtyllat e tregut dhe ato teknike të Paketës së Katërt të Hekurudhave. Hartimi i ligjit të ri për hekurudha dhe ligjit për sigurinë dhe ndërveprueshmërinë hekurudhore është ende në proces. Pavarësisht përfundimit të punimeve në stacionin e përbashkët të hekurudhave me Maqedoninë e Veriut, nisja e operacioneve të përbashkëta është vonuar. Një kontratë shumëvjeçare është nënshkruar ndërmjet menaxhuesit të infrastrukturës dhe autoritetit përkatës.¹⁶⁴ Qeveria ka përfshirë në Planin Legjislativ 2024 dy Projektligje, Projektligjin për Hekurudha dhe Projektligjin për Siguri Hekurudhore. Por asnjërin prej tyre nuk e ka dërguar në Kuvend për miratim.¹⁶⁵ Punimet hekurudhore në Korridorin Orient/East-Med (Rruga Hekurudhore 10) që lidh Fushë Kosovën me Mitrovicën kanë vazhduar me ritëm të ngadaltë. Tenderimi i sistemeve të sinjalizimit dhe telekomunikacionit, që ka prioritet të jashtëzakonshëm, është vonuar. Studimi i fizibilitetit për lidhjen hekurudhore ndërmjet Durrësit dhe Prishtinës është në proces.¹⁶⁶	Në Agjendën e Reformave Evropiane, është vendosur si synim rehabilitimi dhe modernizimi i përgjithshëm i linjave hekurudhore brenda Kosovës të cilat mundësojnë edhe lidhjet hekurudhore me shtetet fqinje të rajonit.¹⁶⁷ 2027
19. Përcaktimi i korridoreve për transportin hekurudhor dhe rrugët ujore të brendshme	Propozimi për rishikimin e Rregullores së Rrjetit Trans-Evropian të Transportit (TEN-T), i cili përfshin një Korridor Hekurudhor të Transportit për Ballkanin Perëndimor, është nën rishikimin e Komisionit Evropian. Pasi të miratohet, RFC-ja e re do të bëhet një mjet thelbësor për bashkëpunim të koordinuar për të përmirësuar trafikun ndërkombëtar të mallrave.¹⁶⁸ Si pjesë e Iniciativës së Korridorit Hekurudhor, Kosova dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor do të marrin pjesë në Korridoret e Transportit Hekurudhor (KTH), një iniciativë e rëndësishme e Komisionit Evropian që synon ringjalljen e transportit hekurudhor të mallrave në Evropë. Nga ana tjetër, si ekonomi pa dalje në det, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut nuk i kanë dhënë përparsi rregullimit të legjislatit detar dhe po bëjnë progres të ngadaltë në këtë fushë.¹⁶⁹	Top of Form n/a

¹⁶⁴ Raporti për Vendin 2024, fq.79.

¹⁶⁵ Shih Planin Legjislativ të Qeverisë së Kosovës në, <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/02/Programi-Legjislativ-per-vitin-2024-.pdf>

¹⁶⁶ Raporti për Vendin 2024, fq.81.

¹⁶⁷ Agjenda e Reformave të Kosovës.

¹⁶⁸ Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Zbatimit të Planit të Veprimit për Agjendën e Gjellbër 2022, fq.38.

¹⁶⁹ Po aty, fq.38.

20. Përcaktimi i një strategjie të përgjithshme për të zhvendosur trafikun nga rruga në modalitete më miqësore me mjedisin.	Një Strategji e Lëvizshmërisë së Qëndrueshme dhe të Zgjuar për Ballkanin Perëndimor u përgatit nga Sekretariati i Komunitetit të Transportit dhe u miratua në korrik 2021. Qëllimi i këtij dokumenti është të paraqesë Strategjinë e Lëvizshmërisë së Qëndrueshme dhe të Zgjuar të BE-së dhe të modifikojë qëllimet, momentet e rëndësishme dhe veprimet e BE-së në situatat në rajonin e Ballkanit Perëndimor.¹⁷⁰ Në maj të vitit 2023, Kosova ka miratuar “Strategjinë e Transportit Multimodal 2023-2030”. Ajo përfshin përpjekje për të rritur përdorimin e transportit hekurudhor dhe ujon si alternativa më të qëndrueshme dhe të sigurta për transportin e mallrave dhe udhëtarëve. Ky synim ndihmon në reduktimin e ndotjes dhe ngarkesës në rrugë, duke kontribuar në mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit.¹⁷¹	Në Agjendën e Reformave, është planifikuar digjitalizimi i sistemeve të transportit të qëndrueshëm, të sigurt, të zgjuar dhe miqësor me mjedisin dhe Zbatimi i Rrjetit Bërthamë/Gjithëpërfshirës ITS onTEN-T në Kosovë. Ky projekt është përfshirë në Strategjinë e Transportit Multi-Modal 2023-2030 dhe është pjesë e Planit të Veprimit të Strategjisë së Transportit Multi-Modal 2023-2025.¹⁷²
21. Identifikimi i standardeve teknike të BE-së dhe siguri i zbatimit dhe i digjitalizimit të të gjitha mënyrave të transportit.	Në Raportin për Vendin 2024, theksohet se Kosova ka bërë disa përparime në fushën e transportit inteligjent, duke miratuar Strategjinë për sistemin e transportit inteligjent 2024-2030. Megjithatë, nevojiten veprime të tjera për të zbatuar acquis-in e BE-së. Kosova duhet të miratojë planin e veprimit për këtë Strategji dhe të sigurojë burime dhe kapacitete të mjaftueshme për implementimin e saj.¹⁷³ Strategjia e Transportit Multimodal për Kosovën 2023-2030 përfshin një fokus në krijimin e një sistemi transporti të zgjuar dhe digjital. Ky objektivi synon të integrojë teknologjitë digjitale në infrastrukturën e transportit për të rritur efikasitetin, sigurinë dhe cilësinë e përgjithshme të shërbimit. Ai pasqyron përkushtimin e Kosovës për të modernizuar sektorin e saj të transportit përmes zgjidhjeve digjitale.¹⁷⁴	Në instrumentin e Reformës Evropiane, është përfshirë edhe vendosja e Sistemit Inteligent të Transportit (ITS) dhe e-transportit të përafruar plotësisht me Direktivën ITS. Po ashtu, parashihet, ndërtimi i stacioneve dhe strehimoreve të digjitalizuara të autobusëve në rrugët nacionale dhe rajonale të Kosovës është në përputhje me objektivat e Agjendës së Reformave të Kosovës, duke përmirësuar infrastrukturën e transportit, duke promovuar praktikën e transportit të qëndrueshëm, duke rritur qasjen në shërbime dhe mundësi, duke integruar teknologjitë inteligjente, duke përmirësuar përvojën e pasagjerëve, duke mbështetur rritjen ekonomike dhe duke kontribuar në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

170 Raporti i Komunitetit të Transportit të BE-së 2021, Strategjia e Lëvizshmërisë së Qëndrueshme dhe të Zgjuar në Ballkanin Perëndimor, fq.7.

171 Strategjia e Transportit Multimodal 2023-2030 në, <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/05/STRATEGJIA-E-TRANSPORTIT-MULTIMODAL-2030.pdf>

172 Agjenda e Reformave Evropiane fq.98.

173 Raporti për Vendin 2024, fq.17.

174 Strategjia e Transportit Multimodal 2023-2030, fq.4.

22. Zbatimi i Planit Rajonal të Veprimit për Përmirësimin e Transportit

Sa i përket përmirësimit të transportit në Raportin për Vendin 2024, theksohet se Kosova ka bërë përparime në sektorin e transportit, duke përfshirë miratimin e planit të veprimit për Strategjinë Multimodale të Transportit (MMTS) për 2023-2030 dhe hapjen e korridorëve ajrore të reja me Shqipërinë. Megjithatë, ende ka sfida të mëdha për t'u përputhur me Acquis-in e BE-së, veçanërisht në transportin rrugor, hekurudhor dhe ajror. Legjislacioni hekurudhor kërkon përputhje të mëtejshme me Paketën e Katërt të Hekurudhës të BE-së. Sistemi i të dhënave për aksidentet kërkon përmirësim, dhe përpjekjet e Këshillit të Sigurisë Rrugore duhet të shtrihen. Në transportin ajror, Kosova has kufizime për shkak të mosanëtarësimit në organizata ndërkombëtare të aviacionit civil. Për më tepër, ndonëse janë bërë përparime në zbatimin e Strategjisë Multimodale, masat për zhvillimin e infrastrukturës intermodale dhe shërbimeve të qëndrueshme logjistike ende duhet të zhvillohen. Forcimi i kapaciteteve administrative dhe operative mbetet thelbësor për zbatimin efektiv të reformave të transportit dhe përputhjen me standardet e BE-së.¹⁷⁵

Ndërsa, përparimi në Rrjetin e Transportit Trans-Evropian (TEN-T) është i kufizuar, kryesisht për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme ndër-institucionale. Rregullorja e rishikuar TEN-T 2024/1679 e 13 Qershorit 2024 ka krijuar një Korridor të ri Transporti Evropian për Ballkanin Perëndimor dhe Mesdheun Lindor, i cili përfshin Kosovën.

Ndërsa, nuk ka pasur përparim në autostradën Prishtinë – Merdare, as në "Rrugën e Paqes". Kurse, puna për hekurudhën në Korridorin 10 që lidh Fushë Kosovën me Mitrovicën ka vazhduar me ritme të ngadalta. Në anën tjetër, dhënia me tender e sistemeve të sinjalistikës dhe telekomunikacionit, që ishte prioritet i madh, u vonua.

Kurse, studimi i fizibilitetit për lidhjen hekurudhore midis Durrësit dhe Prishtinës është ende në proces.¹⁷⁶

Në Agjendën e Reformave, Kosova synon vazhdimin e rehabilitimit të rrjetit kryesor të hekurudhës së Rrjetit të Transportit Trans-Evropian (TEN-T) me investime përgjatë Rrugës Hekurudhore 10, përfshirë lidhjen hekurudhore me Aeroportin e Prishtinës. Një nga objektivat në infrastrukturën rrugore është ndërtimi i rrethrotullimit të Prishtinës, si dhe seksione të tjera të rrjetit kryesor TEN-T.¹⁷⁷

Në Agjendën e Reformave, theksohet se vendosja e Sistemit Inteligjent të Transportit (ITS) është thelbësore për përmirësimin e sigurisë, lëvizshmërisë dhe efikasitetit në transportin e Kosovës, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe mbrojtjen e mjedisit. Aty thuhet se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar të zbatojë ITS dhe ka miratuar Ligjin për Rrugët për të zbatuar Direktivën 2010/40/EN. Megjithatë, Kosova përballlet me mungesë infrastrukture ITS dhe kapacitetesh të pamjaftueshme administrative dhe operacionale, si dhe me sfida të tjera si mbingarkesa e trafikut dhe problemet mjedisore.¹⁷⁸

Objektivi parësor është përafrimi i plotë me Acquis-in e BE-së për ITS, duke forcuar kapacitetet përmes trajnimeve dhe shpërndarjes së materialeve informative për institucionet shtetërore dhe menaxhuesit e hekurudhave. Ai gjithashtu përfshin integrimin e Sistemit Evropian të Menaxhimit të Trafikut Hekurudhor (SEMTH) në rrjetin hekurudhor TEN-T. Objektivi dytësor synon zhvillimin e një kornize të integruar për Sistemet Inteligjente në Transportin Hekurudhor, duke optimizuar përdorimin e ITS-së dhe duke rritur sigurinë dhe menaxhimin e trafikut hekurudhor në rrjetin TEN-T.¹⁷⁹

175 Raporti për Vendin 2024, fq.78, 79.

176 Po aty, fq.81.

177 Agjenda e Reformave Evropiane, fq.18.

178 Agjenda e Reformave, fq.67.

179 Po aty, fq.67.

23.Zbatimi i Planit të Vepërimit për Sigurinë Rrugore

Në prill 2024, qeveria e Kosovës krijoi Këshillin e Sigurisë Rrugore, për të monitoruar zbatimin e dokumenteve strategjike, të koordinojë punën e institucioneve dhe të propozojë politika për përmirësimin e sigurisë rrugore. Megjithatë, sipas KE-së, Kosova duhet të intensifikojë veprimet për të krijuar një sistem të menaxhimit të aseteve rrugore. Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme, sistemi ekzistues i të dhënave të aksidenteve në Kosovë nuk është ende në përputhje me protokollin e të dhënave të aksidenteve të zakonshme (CADaS). Kosova duhet të vazhdojë të rrisë ndërgjegjësimin për të arritur rezultate më të mira, në përputhje me qëllimin e Kombeve të Bashkuara dhe BE-së për të zvogëluar me gjysmë numrin e vdekjeve dhe lëndimeve nga aksidentet rrugore deri në vitin 2030. Përshtatja me Direktivën për menaxhimin e sigurisë së infrastrukturës rrugore ende mbetet e papërfunduar. Krijimi i një sistemi për të rritur kapacitetin e inspektorëve dhe auditorëve të sigurisë rrugore mbetet një prioritet.

Në anën tjetër, edhe Strategjia Multimodale e Transportit 2023-2030, përfshin objektiva të lidhura drejtpërdrejt me rritjen e sigurisë rrugore, duke synuar përmirësimin në këtë fushë.¹⁸⁰

Në vitin 2018, Qeveria e asaj kohe kishte miratuar vendimin për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Trafikut Rrugor (KSTRR).¹⁸¹ Ndërsa me ndërrimin e Qeverisë, ky Këshill u themelua sërish gjatë vitit 2024.¹⁸²

Kosova nuk e ka themeluar ende Agjencinë për Siguri Rrugore, e cila përfshin zhvillimin e sistemit kombëtar për mbledhjen e vazhdueshme të të dhënave të aksidenteve rrugore.¹⁸³

Gjatë vitit 2024, janë regjistruar 21,838 aksidentet trafiku, prej tyre 96 me fatalitet.¹⁸⁴

Edhe në Agjendën e Reformave, është shprehur nevoja për përmirësimin e sigurisë rrugore, uljen e shkallës së aksidenteve dhe minimizimin e ndikimit të incidenteve në fluksin e trafikut.¹⁸⁵

Në mesin e objektivave të Agjendës, mes tjerash është përcaktuar ndërtimi i një infrastrukture teknologjike të avancuar, përmes Zbatimit të Sistemit të Transportit Inteligjent (ITS), për të rritur sigurinë rrugore, për të reduktuar ndjeshëm aksidentet dhe vdekjet në trafik si dhe ndërtimin e një infrastrukture të ngjashme për rritjen e sigurisë hekurudhore.¹⁸⁶

Dhjetor 2027

180 Strategjia e Transportit Multimodal të Kosovës 2030, fq.5.

181 Qeveria e Kosovës, Vendimet nga Mbledhja 198, fq.12.

182 Shih, <https://frontonline.net/themelohet-keshilli-per-siguri-ne-trafikun-rrugor/>

183 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2023, fq.109.

184 Shih, <https://www.gazetaexpress.com/96-te-vdekur-dhe-mbi-21-mije-aksidente-ne-vitin-2024-ne-kosove-shifrat-vleresohen-alarmante/>

185 Po aty, fq.64.

186 Agjenda e Reformave Evropiane, fq.64 dhe 67.

24. Zbatimi i Planit të Vepërimit për Trafikun Rrugor	Në tetor të vitit 2024, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për rrugët,¹⁸⁷ kërkesë kjo edhe e Komisionit Evropian.¹⁸⁸ Kosova ka përparuar me finalizimin e Udhëzimit Administrativ të Direktivës së Sistemit Inteligjent të Transportit (ITS).¹⁸⁹ Kosova ende nuk i ka zbatuar rekomandimet e përshkruara në raportin e projektit të Asistencës Teknike për Lidhshmëri në Ballkanin Perëndimor (CONNECTA) që synon rritjen e cilësisë së rrjetit rrugor.¹⁹⁰ Po ashtu, sistemi i të dhënave për aksidentet në Kosovë ende nuk është në përputhje me protokollin CADaS, i cili kërkon përmirësime për të qenë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kosova duhet të vazhdojë përpjekjet për të arritur qëllimin e OKB-së dhe BE-së për të zvogëluar me gjysmë numrin e vdekjeve dhe lëndimeve nga aksidentet rrugore deri në vitin 2030. Po ashtu, krijimi i një sistemi për rritjen e kapacitetit të inspektorëve dhe auditorëve të sigurisë rrugore mbetet një prioritet për përmirësimin e menaxhimit të trafikut rrugor.¹⁹¹	Në Agjendën e Reformave, theksohet që Kosova përballet me sfida të shumta në transformimin e mënyrave të transportit, përfshirë mungesën e infrastrukturës ITS në nivel lokal dhe kombëtar, përfshirë mungesën e një Qendre të Menaxhimit të Trafikut. Ndërsa, vendi vazhdon të përballet me rritjen e ngarkesës së trafikut dhe sfida mjedisore. Sfida kryesore në përshtatjen me Direktivat ITS dhe implementimin e Sistemit të Transportit Inteligjent (ITS) janë të natyrave të ndryshme. Në këtë drejtim, kapacitetet operative dhe administrative të organeve të zbatimit mbeten të pamjaftueshme.¹⁹²	Dhjetor 2027
25. Zhvillimi dhe zbatimi i planeve të rezistencës ndaj ndryshimeve klimatike për rrjetet e transportit të ekonomive të Ballkanit Perëndimor	Asnjë nga shtetet e Ballkanit Perëndimor nuk ka përgatitur apo miratuar ndonjë strategji të synuar të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike për sektorin e transportit.¹⁹³ Deri më tani, Kosova ka krijuar vetëm një grup pune për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike, duke synuar përfshirjen e planeve të qëndrueshmërisë klimatike në rrjetin e transportit.¹⁹⁴	Në Agjendën e Reformave, theksohet që reduktimi i ndikimit mjedisor të transportit duke ulur emetimet dhe konsumin e karburantit është një tjetër sfidë e madhe që duhet të adresohet. Në kuadër të kësaj, zbatimi i Sistemit të Transportit Inteligjent, ka ndër tjera edhe qëllimin për të ulur ndotjen e trafikut.¹⁹⁵	Dhjetor 2027
26. Promovimi i përgatitjes dhe zbatimit të Planeve të Qëndrueshme të Lëvizjes Urbane për zonat urbane të Ballkanit Perëndimor	Kosova duhet të zhvillojë plane për mobilitetin urban të qëndrueshëm, duke respektuar standardet mjedisore dhe sociale, sipas praktikave të BE-së.¹⁹⁶ Në Strategjinë e Kosovës për Transportin Multimodal 2023-2030, synohet që të rregullohet multimodaliteti i transportit, duke përfshirë të gjitha llojet e transportit dhe lëvizshmërinë urbane.¹⁹⁷ Kryeqyteti i Prishtinës ka hartuar Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban, por një plan i tillë mungon në komunat e tjera.¹⁹⁸	Në Agjendën e Reformave, thuhet se me rritjen e popullsisë urbane dhe ngarkesës së trafikut, ka një nevojë për menaxhimin më efektiv të rrjeteve të transportit.¹⁹⁹ Prandaj, në kuadër të këtij dokumenti është vendosur promovimi i mobilitetit digjital dhe të qëndrueshëm.²⁰⁰ Në këtë drejtim, zbatimi i Sistemit të Transportit Inteligjent (ITS) është thelbësor për përmirësimin e sigurisë, mobilitetit dhe efikasitetit në sistemin e transportit të Kosovës, duke pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, mirëqenien sociale dhe përmirësimin e mjedisit.²⁰¹	Dhjetor 2027

187 Shih Ligjin për Rrugët në, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActId=99115>

188 Raporti për Vendin 2024, fq.17.

189 Po aty, fq. 41.

190 Raporti për Vendin 2023, fq. 110.

191 Raporti për Vendin 2024, fq.78, 79.

192 Agjenda e Reformave, fq.64.

193 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Zbatimit të Planit të Veprimit për Agjendën e Gjellbër 2022, fq. 42.

194 Intervistë e KDI-së me përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, 24 nëntor 2023, Prishtinë.

195 Agjenda e Reformave, fq.64.

196 Raporti për Vendin 2024, fq.78.

197 Strategjia e Transportit Multimodal të Kosovës 2023-2030, fq. 21.

198 Plani i Mobilitetit të Komunës së Prishtinës, në https://prishtinaonline.com/uploads/sump_pristina_final_report_alb.pdf

199 Po aty.

200 Agjenda e Reformave, fq.23.

201 Po aty, fq.64.

27. Përcaktimi i zgjidhjeve për lëvizshmëri të qëndrueshme në nivel rajonal përfshirë planet për zhvillimin e karburanteve alternative.	Përdorimi i energjisë së ripërtëritshme në sektorin e transportit në shtetet e Ballkanit Perëndimor është pothuajse inekzistent dhe asnjëra prej tyre nuk ka miratuar Direktivën e BE-së të Infrastrukturës Alternative të Karburantit, e cila përcakton kërkesat minimale për infrastrukturën e karburanteve alternative. Për më tepër, Direktiva (BE) 2018/2001 për promovimin e përdorimit të energjisë së ripërtëritshme nuk është transpozuar në asnjë nga shtetet.²⁰² Në Raportin për Vendin, KE ka kërkuar nga Kosova që të fillojë të përmirësojë qëndrueshmërinë e transportit ndaj klimës dhe përdorimin e karburanteve alternative, duke respektuar standardet mjedisore dhe sociale, në përputhje me praktikën e BE-së.²⁰³ “Trafiku Urban”, kompani e transportit publik në kuadër të Komunës së Prishtinës, ka lidhur një Marrëveshje Kredie prej 10 milionë eurosh me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për prokurimin e 6 autobusëve elektrikë.²⁰⁴	Në Agjendën e Reformave, theksohet që reduktimi i ndikimit mjedisor të transportit duke ulur emetimet dhe konsumin e karburantit është një tjetër sfidë e madhe që duhet të adresohet.²⁰⁵
27a. Përcaktimi i një plani për ndërtimin e stacioneve të furnizimit për automjetet elektrike.	Në muajin maj 2024 kompania energjetike publike KESCO ka njoftuar se ka instaluar stacione për mbushjen e automjeteve elektrike në të gjitha rrethet në Kosovë si pjesë e iniciativës së saj për promovimin e automjeteve elektrike dhe uljen e ndotjes së ajrit. Me mbi 74,000 euro të investuara në infrastrukturën e furnizimit, KESCO synon të mbështesë një mjedis më të pastër dhe kosto më të ulëta.²⁰⁶	n/a
28. Forcimi i bashkëpunimit rajonal në fushën e zhvillimit të infrastrukturës për alternativat e karburantit.	Progresi i përgjithshëm në bashkëpunimin rajonal në fushën e zhvillimit të infrastrukturës së karburanteve alternative ka qenë i kufizuar. Vlerësimi i përgjithshëm i përmirësimit në fushën e qëndrueshmërisë klimatike dhe karburanteve alternative e vlerëson Kosovën me 8% në vitin 2020 dhe 2021 dhe 0% në vitin 2021 dhe 2022.²⁰⁷ Përmirësimi i bashkëpunimit rajonal në zhvillimin e infrastrukturës për karburante alternative është jo vetëm thelbësor për qëndrueshmërinë mjedisore, por edhe për integrimin ekonomik. Forcimi i këtij bashkëpunimi mund të çojë në përmirësimin e konkurrueshmërisë dhe integrimin më të thellë të vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke u përshatur me standardet e BE-së dhe duke nxitur mirëqenien rajonale.²⁰⁸	n/a

202 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Zbatimit të Planit të Veprimit për Agjendën e Gjelbër 2022, fq. 42.

203 Raporti për Vendin 2024, fq.78.

204 Shih më shumë në, <https://shorturl.at/TE2yI>

205 Po aty.

206 Shih më shumë në, <https://shorturl.at/whwA>

207 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Raporti i Zbatimit të Planit të Veprimit për Agjendën e Gjelbër 2022, fq.43.

208 See, https://www.worldbank.org/en/region/eca/brief/western-balkans-regional-economic-integration?utm_source=chatgpt.com